# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 194

**Tiranë – E enjte, 20 tetor 2016**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Ligj nr. 95/2016 datë 6.10.2016 | Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar................................................................ | 21423 |
| Vendim i Kuvendit nr. 66/2016, datë 6.10.2016 | Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi për përdorimin dhe administrimin nga strukturat e Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit të pajisjes përgjuese "IMSI Cathcer" dhe realizimin nëpërmjet saj të përgjimeve të paligjshme............................................................................................................ | 21456 |
| Dekret i Presidentit nr. 9764, datë 14.10.2016 | Për dhënie të shtetësisë shqiptare........................................................................ | 21457 |

**LIGJ**
**Nr. 95/2016**

# PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

## KREU I
## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
**Objekti i ligjit**

Objekti i këtij ligji është:

1. Përcaktimi i rregullave për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Njësisë së Pavarur Hetimore, si organe kushtetuese, sipas pikës 4, të nenit 148, të Kushtetutës.
2. Përcaktimi i kushteve dhe procedura për emërimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.
3. Përcaktimi i kompetencave lëndore parësore dhe të tjera të gjykatave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokurorisë së Posaçme.
4. Përcaktimi i kushteve dhe kriteret shtesë që duhet të përmbushin shtetasit për t'u emëruar, transferuar apo për t'u ngritur në detyrë si gjyqtarë ose punonjës pranë gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, prokurorë dhe punonjës pranë Prokurorisë së Posaçme, si dhe për t'u punësuar pranë Njësisë së Pavarur Hetimore.
5. Përcaktimi i marrëdhënieve të Prokurorisë së Posaçme me institucione të tjera shtetërore, subjekte të tjera publike apo private, si dhe me publikun.
6. Organizimi dhe funksionimi i procesit të kontrollit të figurës, vëzhgimit të të dhënave financiare dhe vëzhgimit të telekomunikacioneve të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme, Drejtorit, Zëvendësdrejtorit, hetuesve dhe shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit, si dhe vëzhgimit të të dhënave financiare dhe vëzhgimit të telekomunikacioneve të anëtarëve të afërt të familjeve të tyre.

Neni 2
**Qëllimi i ligjit**

Qëllimi i ligjit është:

1. Garantimi i funksionimit të Prokurorisë së Posaçme, si një prokurori e specializuar, për të ushtruar kompetencat e parashikuara në pikën 1, të nenit 148/dh, të Kushtetutës, në mënyrë efikase dhe të pavarur nga çdo ndikim i paligjshëm, i brendshëm apo i jashtëm.
2. Garantimi i funksionimit të Njësisë së Pavarur Hetimore për të hetuar veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe veprat e tjera penale të kryera vetëm nga subjektet e parashikuara në pikën 2, të nenit 135, të Kushtetutës, të pavarur nga çdo ndikim i paligjshëm, i brendshëm apo i jashtëm.

Neni 3
**Përkufizimet**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Anëtar i afërt i familjes" nënkupton bashkëshortin/bashkëshorten, fëmijët mbi 18 vjeç dhe çdo person të lidhur nga gjaku apo martesa, i cili banon më shumë se 120 ditë në vit në të njëjtin vendbanim.
2. "Drejtues të institucioneve shtetërore qendrore ose të pavarura" nënkupton Drejtorin e Policisë së Shtetit, Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Inspektorin e Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Guvernatorin e Bankës Qendrore të Shqipërisë, Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Drejtorin e Shërbimit Informativ Shtetëror.
3. "Gjyqtar" nënkupton çdo person që shërben si gjyqtar në çdo gjykatë të shkallës së parë, Gjykatë të Shkallës së Parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, gjykatë apeli, Gjykatë të Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, gjykatë administrative apo Gjykatën e Lartë.
4. "Informacion sensitiv" nënkupton dokumentet elektronike ose fizike, fotografitë,

regjistrimet, të dhënat, emrat ose çdo informacion tjetër me shkrim ose verbal, që merret gjatë apo si rrjedhojë e një hetimi penal, në përputhje me këtë ligj. Ky informacion nuk konsiderohet sensitiv pasi të jetë bërë publik, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.

5. "Prokuror" nënkupton çdo prokuror në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës të parë, në prokuroritë pranë gjykatave të apeleve, në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe në Prokurorinë e Përgjithshme.

6. "Prokuror më i lartë" është titullari/drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

7. Termi "Struktura e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar" përdoret për t'iu referuar Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Njësisë së Posaçme Hetimore, e cila emërtohet "Byroja Kombëtare e Hetimit". Struktura e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar quhet shkurtimisht "SPAK".

8. "Vepra penale të lidhura me çështjen ose hetimin" nënkupton çdo vepër penale që është kryer me qëllim përgatitjen, mbështetjen, mundësimin, fshehjen ose shmangien e zbulimit të një shkeljeje penale që është në kompetencën kryesore të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ky përkufizim përfshin gjithashtu çdo shkelje penale që pengon hetimin e çështjes, kanos dëshmitarët, viktimat, gjyqtarët, prokurorët, hetuesit ose punonjësit, apo shkatërron ose i bën provat të papërdorshme në mënyra të tjera.

Neni 4
**Prokuroria e Posaçme**

1. Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në emër të shtetit para Gjykatës së Shkallës së Parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, dhe Gjykatës së Lartë, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, si dhe kryen detyra të tjera të ngarkuara me ligj.

2. Prokuroria e Posaçme i kryen funksionet e saj në mënyrë të pavarur, nëpërmjet prokurorëve të posaçëm, të cilët emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë në përputhje me këtë ligj.

Neni 5
**Byroja Kombëtare e Hetimit**

1. Byroja Kombëtare e Hetimit është strukturë e specializuar e Policisë Gjyqësore, që heton veprat penale në juridiksionin penal të Prokurorisë së Posaçme, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale.

2. Byroja Kombëtare e Hetimit ka në përbërje të saj hetuesit dhe Shërbimet e Policisë Gjyqësore sipas këtij ligji.

3. Drejtuesi i Byrosë Kombëtare të Hetimit, hetuesit dhe shërbimet e Policisë Gjyqësore drejtohen dhe kontrollohen nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme.

Neni 6
**Procedura e verifikimit të kushteve të sigurisë përpara emërimit në detyrë**

1. Kandidati për gjyqtar dhe nëpunës civil gjyqësor në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, për prokuror dhe personel administrativ në Prokurorinë e Posaçme, dhe për drejtor dhe hetues në Byronë Kombëtare të Hetimit duhet të plotësojë kushtet e sigurisë përpara se të caktohet apo punësohet në një nga këto pozicione. Asnjë kandidat nuk mund të caktohet në detyrë ose të punësohet pa plotësuar këto kushte. Të njëjtat kushte duhet të plotësohen nga çdo punonjës i Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit, të cilët kryejnë funksione hetimore ose funksionet e të cilëve mbështesin drejtpërsëdrejti hetimin. Kushtet e sigurisë para caktimit në detyrë ose emërimit janë:

a) kontrolli i verifikimit të pasurisë dhe të figurës;

b) dhënia e pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, për të cilën kandidati plotëson dhe nënshkruan një deklaratë me shkrim, sipas shtojcave B1 dhe B2 të këtij ligji; si dhe

c) dhënia e pëlqimit prej anëtarëve të afërt të familjes për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, për të cilën anëtari i afërt i familjes plotëson dhe nënshkruan një deklaratë me shkrim, sipas shtojcës B3 të këtij ligji.

2. Kandidati, bashkë me kërkesën për aplikim, plotëson dhe dorëzon deklaratat e kontrollit të pasurive dhe të konfliktit të interesit pranë

institucioneve përkatëse të emërtesës. Nëse, gjatë 180 ditëve para se të paraqiste kërkesën, kandidati ka kaluar një kontroll të kryer prej Inspektoratit të Lartë të Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, i cili nuk ka rezultuar në disfavor të tij, atëherë ky kriter do të konsiderohet si i përmbushur.

3. Kandidati plotëson deklaratën e kontrollit të figurës, sipas shtojcës A, të këtij ligji, dhe e dorëzon atë tek institucionet e emërtesës.

4. Kandidati dhe anëtarët e afërt të familjes plotësojnë dhe nënshkruajnë vetëdeklarimin, sipas shtojcës B3, të këtij ligji, sipas së cilës, nëse caktohet në detyrë apo punësohet, telekomunikimet e tyre, si dhe llogaritë bankare do të jenë objekt vëzhgimi, si dhe heqin dorë nga e drejta e jetës private lidhur me këto komunikime, si dhe i dorëzojnë ato tek institucionet e emërtesës.

5. Gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit krijojnë Komisionin e Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve për të bërë verifikimin e kushteve të sigurisë para caktimit në detyrë ose emërimit, të përbërë nga:

a) dy prokurorë të Prokurorisë së Posaçme, të zgjedhur me short. Procesi i përzgjedhjes me short monitorohet nga Avokati i Popullit;

b) një gjyqtar të gjykatave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, i zgjedhur me short. Procesi i përzgjedhjes me short monitorohet nga Avokati i Popullit;

c) një punonjës i seksionit të hetimit financiar pranë Prokurorisë së Posaçme, i caktuar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme;

ç) një hetues i Byrosë Kombëtare të Hetimit, i caktuar nga Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit.

6. Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve, pasi merr nga institucionet përkatëse të emërtesës deklaratat, sipas pikave 2, 3 dhe 4, të këtij neni, kryen verifikimet e nevojshme për pasurinë dhe figurën dhe, brenda 120 ditëve, i dorëzon institucionit të emërtesës një raport të hollësishëm mbi ligjshmërinë e burimeve të pasurisë dhe pastërtinë e figurës, si dhe çdo dokumentacion tjetër mbështetës të paraqitur nga vetë kandidatët apo institucionet shtetërore, të cilat bëhen pjesë e dosjes së kandidatit, sipas legjislacionit në fuqi. Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe të Figurës së Kandidatëve, përveç dokumentacionit të paraqitur nga vetë kandidatët, mund të kërkojë të dhëna ose informacione zyrtare nga çdo institucion shtetëror në lidhje me kandidatët. Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe të Figurës së Kandidatëve u kërkon informacion institucioneve shtetërore, objekti i ligjshëm i veprimtarisë së të cilave lidhet me hetimin dhe mbledhjen e të dhënave mbi pasurinë dhe figurën e individit, duke i caktuar detyra konkrete dhe afate për përmbushjen e tyre. Institucioni shtetëror përkatës është i detyruar që të paraqesë informacionin ose dokumentacionin e kërkuar brenda 15 ditëve nga data e njoftimit. Këto akte bëhen pjesë e dosjes së kandidatit dhe trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Të dhënat dhe informacionet zyrtare mund t'i vihen në dispozicion kandidatit, mbi bazën e një kërkese të arsyetuar dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar. Në rast se përhapja e informacionit apo dokumenteve cenon informacionin e klasifikuar sekret apo sigurinë publike, atëherë Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe të Figurës së Kandidatëve, pasi njihet me to, nuk i përfshin në dosjen individuale të kandidatit dhe është i detyruar të ruajë konfidencialitetin mbi përmbajtjen e tyre.

Neni 7

**Procesi i aplikimit**

1. Plotësimi i vendeve vakante pranë Strukturës së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar bëhet i hapur dhe transparent.

2. Procesi i hapur dhe transparent përfshin si rregull:

a) aplikimin, që në mënyrë të qartë parashikon minimumin e kualifikimeve për pozicionin dhe numrin e vendeve vakante;

b) njoftimin për aplikim që:

- publikohet të paktën dy javë përpara përfundimit të afatit të dorëzimit të tyre në *website*-n e institucionit;
- specifikon afatin përfundimtar të aplikimit që është jo më pak se dy javë nga data e publikimit;
- specifikon informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar për t'u dorëzuar bashkë me aplikimin;
- specifikon procedurën për aplikimet dhe se ku duhen dorëzuar ato;

c) rubrikën për vlerësimin e të gjithë aplikantëve bazuar në meritat e tyre;

ç) rubrikën që informon rreth komisionit dhe përbërjes të tij, që bën përzgjedhjen dhe rekomandimet;

d) informimin në kohën e duhur të aplikuesve rreth rezultateve të konkursit.

KREU II
KOMPETENCAT

Neni 8
**Kompetenca lëndore parësore**

1. Kompetenca lëndore parësore e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar parashikohet në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, por nuk mund të tejkalojë kompetencën e përcaktuar nga neni 135, pika 2, të Kushtetutës.

2. Gjykata kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokuroria e Posaçme janë kompetente për të shqyrtuar, hetuar dhe ndjekur penalisht çdo vepër penale, sipas pikës 1, të këtij neni, edhe në rastet kur nuk ngrihet akuzë kundër një zyrtari, sipas nenit 135, pika 2, të Kushtetutës, ose kundër një drejtuesi të një institucioni qendror ose të pavarur, sipas këtij ligji, ose nëse ai zyrtar publik ose zyrtar i lartë largohet gjatë kohëzgjatjes së hetimit.

Neni 9
**Kompetenca lëndore të tjera**

1. Gjykata kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokuroria e Posaçme kanë kompetencë për të shqyrtuar, hetuar dhe ndjekur penalisht çdo vepër penale tjetër që është e lidhur ngushtë me hetimin apo çështjen penale brenda kompetencave të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji.

2. Prokuroria e Posaçme, në ushtrimin e ndjekjes penale, sipas parashikimeve të nenit 8, të këtij ligji, ka kompetencë për të kërkuar nga gjyqtarët e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, zbatimin e dispozitave të legjislacionit në fuqi për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë.

3. Prokuroria e Posaçme, në ushtrimin e ndjekjes penale, sipas parashikimeve të nenit 8, të këtij ligji, ka kompetencë për të kërkuar zbatimin e dispozitave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë.

4. Gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar kanë kompetenca mbi hetimet, çështjet dhe kërkesat e paraqitura në përputhje me këtë nen.

Neni 10
**Juridiksioni penal**

1. Gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Struktura e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar e kanë vendndodhjen në Tiranë dhe e ushtrojnë juridiksionin e tyre penal në të gjithë territorin e Shqipërisë. Byroja Kombëtare e Hetimit mund të krijojë zyra të përkohshme ose të përhershme jashtë Tiranës, për të përmbushur qëllimin e saj.

2. Prokuroria e Posaçme ka juridiksion penal për hetimin dhe ndjekjen penale të çdo vepre të parashikuar nga nenet 8 dhe 9, të këtij ligji, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

KREU III
PROKURORIA E POSAÇME

Neni 11
**Prokuroria e Posaçme**

1. Prokuroria e Posaçme përbëhet nga drejtuesi i prokurorisë dhe nga prokurorët e posaçëm.

2. Dispozitat e ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" zbatohen edhe për organizimin dhe veprimtarinë e Prokurorisë së Posaçme, përveçse kur ky ligj parashikon ndryshe.

3. Prokuroria e Posaçme ushtron funksionet përmes prokurorëve të posaçëm dhe sektorëve mbështetës në përputhje me këtë ligj. Hetuesit dhe shërbimet e Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit drejtohen dhe kontrollohen nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme.

Neni 12
**Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme**

1. Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në përputhje me parashikimet e nenit 148/dh të Kushtetutës dhe legjislacionin në fuqi.

2. Kandidatët për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme duhet të përmbushin parakushtet e sigurisë të nenit 6 të këtij ligji. Një kandidat nuk mund të caktohet në detyrë në Prokurorinë e Posaçme pa përmbushur parakushtet e sigurisë dhe

kushtet e aftësive profesionale. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, përpara emërimit, sipas parashikimeve të ligjit për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, administron, shqyrton dhe vlerëson edhe dokumentacionin e secilit kandidat të ardhur nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe të Figurës së Kandidatëve. Kandidati, i cili merr një vlerësim negativ nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe të Figurës së Kandidatëve, bazuar në ligj dhe në prova, nuk mund të emërohet si prokuror në Prokurorinë e Posaçme. Vendimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë është i formës së prerë.

3. Prokurorët emërohen në detyrë nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për një mandat nëntëvjeçar. Mandati pezullohet apo ndërpritet vetëm nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë kërkon procedim disiplinor kundër prokurorit.

4. Në përfundim të mandatit të prokurorit të posaçëm, Këshilli i Lartë i Prokurorisë e kthen atë në pozicionin e tij të mëparshëm ose në pozicione të lira në zyra të tjera të sistemit të prokurorisë, duke marrë përparësi mbi kandidatët e tjerë.

Neni 13

**Pavarësia e prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme**

1. Prokurorët e posaçëm, në ushtrimin e funksioneve të tyre, veprojnë dhe marrin vendime në mënyrë të pavarur, bazuar në parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë.

2. Prokurorët e posaçëm zbatojnë udhëzimet e përgjithshme, të dhëna me shkrim nga prokurori më i lartë, sipas këtij ligji. Prokurori më i lartë nuk mund t'i japë udhëzime një prokurori të posaçëm lidhur me thelbin e hetimit apo çështjes.

3. Ligji garanton pavarësinë dhe autonominë e nevojshme për marrjen e vendimeve gjatë ushtrimit nga prokurorët të funksionit të tyre kushtetues e ligjor, pavarësisht ndikimit të paligjshëm, të brendshëm apo të jashtëm, nga çdo autoritet publik a privat.

Neni 14

**Përgjegjshmëria**

Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme, kur kanë dyshime të arsyeshme për kryerjen e një vepre penale, hetojnë dhe ndjekin penalisht prokurorë të Prokurorisë së Posaçme ose gjyqtarë të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Neni 15

**Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme**

1. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme zgjidhet në përputhje me nenin 148/dh, pika 3, të Kushtetutës.

2. Drejtuesi Prokurorisë së Posaçme ushtron funksionet dhe kompetencat e mëposhtme:

a) është drejtues administrativ i punonjësve të Prokurorisë së Posaçme. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme nuk i jep udhëzime një prokurori të posaçëm lidhur me thelbin e hetimeve apo çështjes penale të ndjekur prej tij;

b) u cakton çështje prokurorëve të posaçëm bazuar në specializimin e tyre;

c) koordinon punën e njësive që janë në kompetencë të tij me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit, shërbimet e inteligjencës dhe autoritetet e tjera kompetente;

ç) i paraqet Ministrisë së Financave projekt-buxhetin për Prokurorinë e Posaçme dhe Byronë Kombëtare të Hetimit;

d) brenda datës 1 mars, i dorëzon Këshillit të Lartë të Prokurorisë një raport vjetor me shkrim mbi veprimtarinë e Prokurorisë së Posaçme;

dh) thërret mbledhjen e Prokurorisë së Posaçme, kur është e nevojshme;

e) nxjerr udhëzime të përgjithshme me shkrim në lidhje me procedurat administrative, si dhe rregullore për funksionimin e Prokurorisë së Posaçme;

ë) pas konsultimit me Drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe mbledhjes së prokurorëve të posaçëm, nxjerr udhëzime të përgjithshme me shkrim për Byronë Kombëtare të Hetimit, të cilat përmirësojnë marrëdhëniet e punës, efikasitetin apo garancitë mes dy strukturave;

f) miraton rregulloret e nxjerra nga Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit;

g) cakton, në mungesë të tij, një prokuror tjetër të posaçëm në rolin e Drejtuesit të Komanduar të Prokurorisë së Posaçme. Nëse kjo mungesë zgjat më shumë se 45 ditë, ose përsëritet vazhdimisht, Këshilli i Lartë i Prokurorisë komandon një prokuror të posaçëm si Drejtues të Prokurorisë së Posaçme për një periudhë kohore të përcaktuar, si dhe mban parasysh nëse mungesa e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme është e justifikuar apo përbën shkelje serioze të disiplinës.

Neni 16
**Mbledhja e prokurorëve të posaçëm**

1. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme thërret dhe drejton mbledhjen e prokurorëve të strukturës përkatëse, për të diskutuar çështje me rëndësi të veprimtarisë së prokurorisë.

2. Mbledhja e Prokurorëve të Posaçëm ka detyrat e mëposhtme:

a) jep mendim mbi rregulloren e brendshme administrative të organizimit dhe funksionimit të Prokurorisë së Posaçme dhe rregulloreve të nxjerra nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme;

b) jep mendim lidhur me përshkrimet e punës të të gjitha kategorive të nëpunësve civilë dhe punonjësve të Prokurorisë së Posaçme dhe aftësitë e personave në detyrë;

c) jep mendim për ngritjen e komisioneve të brendshme sipas nevojës;

ç) jep mendim mbi projektbuxhetin e prokurorisë përkatëse, përpara se të dërgohet në Kuvendin e Shqipërisë;

d) diskuton çdo çështje tjetër me rëndësi për veprimtarinë e Prokurorisë së Posaçme, përfshirë ato që lidhen me personelin, disiplinën, sigurinë, si dhe çështje të tjera që garantojnë mbarëvajtjen e punës normale në këtë prokurori;

3. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka detyrimin të thërrasë mbledhjen e prokurorëve të posaçëm, kur kjo kërkohet nga të paktën një e treta e trupës së prokurorëve.

Neni 17
**Struktura e Prokurorisë së Posaçme**

1. Prokuroria e Posaçme mbështetet nga personeli i këtyre sektorëve:

a) Kancelari;

b) Sektori i Dokumentacionit;

c) Sektori i Ekspertizës;

ç) Sektori i Hetimit Financiar;

d) Sektori i Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Ndërlidhjes për Hetimet e Përbashkëta;

dh) Sektori për Asistencën për Individët me Status të Posaçëm;

e) Koordinatori për Marrëdhënien me Mediat.

2. Të gjithë kandidatët për personel të Prokurorisë së Posaçme duhet të përmbushin kushtet e sigurisë, sipas nenit 6 dhe kreut VIII të këtij ligji.

Neni 18
**Kancelari**

1. Kancelari i Prokurorisë së Posaçme, është nëpunësi civil më i lartë i Prokurorisë së Posaçme, i cili mbikëqyr veprimtarinë e personelit administrativ, administron mjediset e punës, dosjet, arkivin, shërbimet mbështetëse dhe financat e Prokurorisë. Kancelari përgjigjet para Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

2. Kancelari i Prokurorisë së Posaçme kryen funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm për Prokurorinë e Posaçme dhe është përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditin e brendshëm të buxhetit të Prokurorisë së Posaçme, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe të legjislacionit për menaxhimin buxhetor dhe financiar.

3. Kancelari i Prokurorisë së Posaçme barazohet në pagë me funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm në Prokurorinë e Përgjithshme.

Neni 19
**Sektori i Dokumentacionit**

1. Sektori i Dokumentacionit në Prokurorinë e Posaçme kryen këto detyra:

a) mbledh në mënyrë sistematike të dhëna për rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar;

b) krijon dhe mban një bazë të dhënash që shërben si burim informacioni në procedimet për vepra penale, të parashikuara në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale;

c) i përcjell Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë të dhëna statistikore sipas kompetencave të tyre;

ç) kryen detyra të tjera të nevojshme për punën e zyrës.

2. Sektori i Dokumentacionit në Prokurorinë e Posaçme bashkëpunon me Arkivin Shtetëror për ruajtjen, përpunimin dhe administrimin e dokumentacionit të Prokurorisë së Posaçme, i cili i nënshtrohet procedurës së arkivimit.

Neni 20
**Sektori i Ekspertizës**

1. Prokuroria e Posaçme ka personel ekspertë që ndihmojnë në hetime dhe mund të dëshmojnë në gjyq.

2. Ekspertët duhet të jenë të specializuar në fusha të ndryshme për të ndihmuar Prokurorinë e Posaçme në ushtrimin e funksioneve të saj. Prokuroria ka të paktën një ekspert kontabël dhe një ekspert të teknologjisë së informacionit.

3. Ekspertët duhet minimalisht të kenë përfunduar studimet në nivelin "Master i shkencave" në fushën e tyre të ekspertizës.

4. Ekspertët duhet të kenë të paktën pesë vjet përvojë në fushën e tyre të ekspertizës.

5. Punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, të cilët janë të kualifikuar sipas këtij neni, mund të japin ndihmesën e tyre, si ekspertë, në hetime apo të dëshmojnë.

Neni 21
**Sektori i Hetimit Financiar**

1. Sektori i Hetimit Financiar në Prokurorinë e Posaçme verifikon mjetet financiare dhe pasuritë e personave nën hetim dhe raporton rezultatet te prokurori i posaçëm kompetent.

2. Punonjësit e këtij sektori janë të diplomuar në drejtësi, financë apo në fusha të tjera përkatëse.

3. Punonjësit e këtij sektori duhet të kenë një eksperiencë pune jo më pak se dy vjet si oficerë të Policisë Gjyqësore.

Neni 22
**Sektori për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta**

1. Sektori për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta në Prokurorinë e Posaçme është përgjegjës për koordinimin e punës së saj me autoritetet e shteteve të tjera. Sektori shërben si ndërlidhës me organet e huaja në shërbim të ecurisë së hetimeve apo hetimeve të përbashkëta.

2. Sektori drejtohet nga një prokuror i posaçëm, i caktuar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme për një periudhë trevjeçare.

3. Punonjësit e këtij sektori duhet të kenë diplomë masteri të nivelit të dytë në drejtësi ose arsim të lartë juridik të njësuar me të sipas ligjit për arsimin e lartë.

4. Ndërlidhësi duhet të ketë të paktën pesë vite përvojë në fushën e drejtësisë, si dhe duhet të zotërojë rrjedhshëm gjuhën shqipe dhe angleze.

Neni 23
**Detyrat e Sektorit për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta**

1. Sektori për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta:

a) bashkëpunon me autoritete kompetente të shteteve të tjera dhe organizatave ndërkombëtare në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare;

b) cakton anëtarë në strukturat e përbashkëta hetimore, të krijuara në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare ose në bazë të një marrëveshje për një rast konkret, me qëllim hetimin, ndjekjen penale apo përfaqësimin në gjyq të veprave penale të parashikuara nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, në Republikën e Shqipërisë, në një ose më shumë shtete të tjera;

c) mbikëqyr hetimet e përbashkëta brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, zbatimin e legjislacionit të brendshëm, si dhe respektimin e sovranitetit të Republikës së Shqipërisë;

ç) informon në lidhje me problemet e identifikuara apo çështjet e debatuara, të cilat nuk mund të zgjidhen nëpërmjet konsultimeve me organet kompetente të një shteti tjetër apo përfaqësuesve të tij, informon pa vonesë Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, i cili, nëse është e nevojshme, kërkon mendimin ose ndihmën e ministrisë kompetente.

2. Për nevojat e hetimeve të përbashkëta, ndërlidhësi:

a) merr kërkesat e shteteve të tjera për të bërë hetime të posaçme për çështjen penale, ndërmerr veprimet e nevojshme para gjykatave kompetente dhe ofron ndihmë ligjore në procedime për vepra penale të parashikuara nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale;

b) mbikëqyr veprimtarinë e organit kompetent të shtetit të huaj, që është i autorizuar të veprojë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në rast të një çështjeje penale urgjente, për të garantuar mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të qytetarëve shqiptarë;

c) i dorëzon një raport përfundimtar Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme për veprimet e kryera, sipas parashikimit të shkronjës "b", pika 2, të këtij neni. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme mund të kërkojë praninë e një nëpunësi të huaj të autorizuar gjatë dorëzimit të raportit.

Neni 24
**Koordinatori për Marrëdhëniet me Mediat**

1. Koordinatori për Marrëdhëniet me Mediat në Prokurorinë e Posaçme kryen ndërlidhjen mes prokurorisë dhe mediave kombëtare e ndërkombëtare.
2. Koordinatori i Marrëdhënieve me Mediat është i vetmi person i autorizuar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme për të komunikuar me mediat në emër të Prokurorisë së Posaçme, në lidhje me hetime apo çështje penale.
3. Koordinatori i Marrëdhënieve me Mediat duhet të jetë i diplomuar në një fushë që lidhet me detyrën dhe të ketë të paktën pesë vite përvojë pune në një organizatë mediatike apo si ndërlidhës shtypi i një agjencie publike ose një organizate ndërkombëtare.
4. Koordinatori i Marrëdhënieve me Mediat kryen këto detyra:
a) informon publikun për format e rrezikut, pasojat e korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe për metodat e instrumentet për parandalimin e tij;
b) nën drejtimin dhe bazuar në udhëzimet e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, informon publikun për punën e zyrës;
c) kryen detyra të tjera, bazuar në planin vjetor të punës së zyrës.
5. Punonjësit e marrëdhënieve me mediat duhet të zotërojnë rrjedhshëm gjuhën shqipe dhe atë angleze.

Neni 25
**Sektori për Asistencën për Individët me Status të Posaçëm**

1. Prokuroria e Posaçme ka një sektor që ofron shërbime për individët me status të posaçëm, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, përfshirë viktimat e krimeve, të cilët janë brenda kompetencave të kësaj prokurorie, si dhe për dëshmitarët në hetimet dhe çështjet e ndjekura nga kjo prokurori, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Numri i koordinatorëve të këtij sektori është në varësi të numrit të çështjeve penale që hetohen nga Prokuroria e Posaçme, por në çdo rast ky numër nuk mund të jetë më pak se dy koordinatorë.
3. Koordinatorët duhet të kenë diplomë nga një universitet i licencuar në degët e psikologjisë ose sociologjisë ose fusha të tjera të posaçme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 26
**Mbikëqyrja e punonjësve dhe ekspertëve**

1. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe drejtuesit e sektorëve kryejnë mbikëqyrjen administrative të marrjes në punë, trajnimin, disiplinën dhe vlerësimin e punonjësve dhe ekspertëve të Prokurorisë së Posaçme, si dhe i caktojnë ata të punojnë me prokurorët.
2. Prokurorët e posaçëm mbikëqyrin çdo punonjës dhe ekspert në hetimet dhe çështjet që u janë caktuar.
3. Ekspertët japin mendime të bazuara në prova, fakte, ekspertizë dhe rezultate analizash. Ata nuk mund të japin mendim për themelin e çështjes.

Neni 27
**Përfaqësimi**

1. Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme i përfaqësojnë çështjet e tyre në Gjykatën e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në Gjykatën e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, dhe në Gjykatën e Lartë.
2. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, kur e çmon të nevojshme, mund t'i kërkojë Prokurorit të Përgjithshëm të caktojë prokurorë nga Prokuroria e Përgjithshme për të përgatitur apo përfaqësuar akuzën në Gjykatën e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ose në Gjykatën e Lartë, kur ekspertiza apo asistenca profesionale është e nevojshme në funksion të cilësisë së përfaqësimit.

KREU IV
BASHKËPUNIMI ME ORGANET E TJERA

Neni 28
**Detyrimet e organeve të tjera shtetërore**

1. Të gjitha organet e pushtetit shtetëror dhe të gjitha subjektet juridike, të cilat, në kryerjen e aktiviteteve të tyre, vijnë në dijeni për rrethana dhe të dhëna për vepra penale të parashikuara në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, janë të detyruar t'i referojnë këto rrethana ose të njoftojnë menjëherë Byronë Kombëtare të Hetimit ose

Prokurorinë e Posaçme.

2. Të gjitha organet shtetërore janë të detyruara të bashkëpunojnë me Prokurorinë e Posaçme dhe Byronë Kombëtare të Hetimit për hetimin e çështjeve penale, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit kanë akses të drejtpërdrejtë në sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave të administruara nga institucionet shtetërore, që përmbajnë informacionin e duhur për hetimin e veprave penale të parashikuara në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale. Organet shtetërore kanë detyrim të japin informacion brenda 24 orëve ose, në qoftë se baza e të dhënave ekziston, t'i japin akses të drejtpërdrejtë Prokurorisë së Posaçme. Ky akses vendoset në mënyrë të përhershme brenda një afati kohor të arsyeshëm, por jo më shumë se 6 muaj dhe vetëm në bazë të një kërkese me shkrim nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme drejtuar titullarit të institucionit shtetëror.

4. Parashikimet e bëra në pikën 3 të këtij neni nuk zbatohen për sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave që janë të certifikuara si sekret shtetëror. Aksesi i Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit në sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave duhet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror.

Neni 29

**Detyrimet e Policisë së Shtetit**

1. Çdo punonjës i Policisë së Shtetit kur vjen në dijeni për kryerjen e një vepre penale të parashikuar në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, njofton menjëherë Byronë Kombëtare të Hetimit. Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit nxjerr një rregullore mbi metodologjinë e informimit të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

2. Prokuroria e Posaçme, pas marrjes së njoftimit të përmendur në pikën 1, të këtij neni, nëse vlerëson se është kryer një vepër penale në kompetencë të saj, fillon menjëherë procedimin penal për hetimin e çështjes. Prokuroria e Posaçme njofton pa vonesë policinë dhe prokurorinë përkatëse që ka qenë duke proceduar penalisht rastin deri në atë moment, duke kërkuar prej tyre deklarimin e moskompetencës lëndore dhe marrjen e akteve procedurale të përpiluara gjatë hetimit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.

3. Prokurori në Prokurorinë e Posaçme kur vlerëson se nuk ka të dhëna për veprën penale, për të cilën kjo prokurori është kompetente, ia raporton këtë fakt Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme njofton ose i referon aktet zyrës përkatëse të prokurorisë që do të vazhdojë procedurën, si dhe njofton çdo strukturë tjetër.

4. Çdo oficer i Policisë së Shtetit, agjent apo oficer i Policisë Gjyqësore ekzekuton urdhrat e prokurorit të Prokurorisë së Posaçme ose vendimet e gjykatës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, për kontrolle ose arrestime, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, kur urdhri parashikon se ekzekutimi duhet të kryhet prej tij. Ata përmbushin edhe çdo detyrë apo kërkesë tjetër ligjore të urdhëruar nga një prokuror i posaçëm ose nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

Neni 30

**Detyrimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, nëse ekziston dyshim për pastrimin e produkteve të veprës penale të referuara në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale:

a) informon Prokurorinë e Posaçme për mjete financiare, të ardhura ose pasuri, për të cilat ka marrë dijeni në çfarëdo mënyre kur këto janë fituar përmes kryerjes së një vepre penale të parashikuar në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale;

b) kërkon që subjektet e detyruara për zbatimin e masave kundër pastrimit të produkteve të veprës penale të japin të gjitha të dhënat lidhur me transaksionet e bëra nga personat e dyshuar dhe t'ia dërgojnë menjëherë këto të dhëna Prokurorisë së Posaçme.

2. Me kërkesë të Prokurorisë së Posaçme, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave vë në dispozicion të gjitha të dhënat që disponon mbi transaksionet e personave të dyshuar për pastrim të produkteve të veprës penale dhe kryen kontrollet e nevojshme për të vërtetuar ekzistencën e këtyre transaksioneve.

3. Inspektorët shtetërorë të autorizuar për sekuestrimin e përkohshëm të objekteve, instrumenteve ose pasurive të dyshuara i dorëzojnë

Prokurorisë së Posaçme, së bashku me njoftimin, një raport mbi veprimet e kryera dhe transkriptin e vendimit për konfiskim apo sekuestrim.

KREU V
BYROJA KOMBËTARE E HETIMIT

Neni 31
**Byroja Kombëtare e Hetimit**

1. Byroja Kombëtare e Hetimit është një strukturë e specializuar e Policisë Gjyqësore, që vepron vetëm nën drejtimin e Prokurorisë së Posaçme. Drejtori, Zëvendësdrejtori dhe hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit gëzojnë statusin e oficerit të Policisë Gjyqësore.

2. Organizimi i brendshëm i Byrosë Kombëtare të Hetimit rregullohet nga urdhri i përbashkët i Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

3. Byroja Kombëtare e Hetimit përbëhet nga drejtori, zëvendësdrejtori, hetuesit dhe punonjësit e administratës. Ajo ka gjithashtu në përbërje të saj shërbime të Policisë Gjyqësore, të përbëra nga oficerë të Policisë Gjyqësore, nga Policia e Shtetit dhe institucionet e tjera përkatëse, të cilët janë nën drejtimin administrativ të Zëvendësdrejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe nën varësi procedurale hetimore të Prokurorisë së Posaçme. Punonjësit e shërbimeve mund të qëndrojnë në mjediset e Byrosë Kombëtare të Hetimit, ato të Policisë së Shtetit apo ato të institucioneve përkatëse, sipas nevojave të përcaktuara nga Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

4. Organizimi dhe funksionimi i shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit rregullohet në përputhje me këtë ligj dhe urdhrat e Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, me pëlqimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

Neni 32
**Punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit**

1. Kandidatët për punonjës në Byrosë Kombëtare të Hetimit, përfshi drejtorin, zëvendësdrejtorin, hetuesit, punonjësit dhe oficerët e shërbimeve të Policisë Gjyqësore duhet të përmbushin kushtet e sigurisë, të përcaktuara në nenin 6 dhe kreun VIII të këtij ligji. Një kandidat nuk mund të emërohet në Byronë Kombëtare të Hetimit apo në shërbimet e Policisë Gjyqësore pranë saj, pa përmbushur kriteret dhe pa iu nënshtruar kushteve të sigurisë.

2. Kandidatët për drejtor apo hetues pranë Byrosë Kombëtare të Hetimit duhet të përmbushin kushtet e pikës 1, të këtij neni, dhe përpara emërimit duhet të kenë përfunduar programin e nevojshëm të trajnimit.

3. Kandidatët për oficerë të Policisë Gjyqësore të shërbimeve, të cilët përmbushin kushtet e pikës 1, të këtij neni, brenda 2 muajve nga emërimi, duhet të kenë përfunduar programin e nevojshëm të trajnimit.

Neni 33
**Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit**

1. Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit është përgjegjës për funksionimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit.

2. Komisioni i përbërë nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe dy prokurorë të posaçëm me më shumë vite eksperiencë pune si prokuror, pas një procesi rekrutimi të hapur dhe transparent, rekomandojnë një kandidat për Drejtor të Byrosë Kombëtare të Hetimit, i cili emërohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Drejtori emërohet për një mandat 5-vjeçar, me të drejtë riemërimi një herë.

3. Kandidatët për Drejtor të Byrosë Kombëtare të Hetimit duhet të përmbushin kushtet e sigurisë të nenit 6 të këtij ligji. Një kandidat nuk mund të caktohet në detyrë si Drejtor i Byrosë Kombëtare të Hetimit pa përmbushur kushtet e sigurisë dhe kushtet e aftësive profesionale.

4. Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit, pas përfundimit të mandatit, gëzon të drejtën të kthehet në pozicionin e mëparshëm ose të emërohet në një pozicion të të njëjtit nivel, me një gradë që i korrespondon atij funksioni.

5. Drejtori mbikëqyret nga një komision i përbërë prej tre prokurorësh të Prokurorisë së Posaçme, njëri prej të cilëve është drejtuesi i saj dhe dy të tjerët zgjidhen çdo vit me short.

6. Drejtori, me pëlqimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, përzgjedh nga radhët e hetuesve një zëvendësdrejtor. Zëvendësdrejtori vepron në emër të drejtorit në mungesë të tij.

7. Drejtori cakton hetues për të drejtuar sektorë brenda Byrosë Kombëtare të Hetimit, në përputhje me urdhrin e përbashkët të nxjerrë në bazë të nenit 31, pika 2, të këtij ligji.

Neni 34
**Kriteret e emërimit të Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit**

1. Kandidati për Drejtor i Byrosë Kombëtare të Hetimit duhet të përmbushë të gjitha kushtet e parashikuara në nenin 6, pika 3, të nenit 37, si dhe pikat 2 dhe 3, të nenit 38, të këtij ligji. Ai duhet të plotësojë me sukses kriteret e përzgjedhjes dhe trajnimit për Byronë Kombëtare të Hetimit.

2. Kandidati për Drejtor i Byrosë Kombëtare të Hetimit mund të jetë personi që ka vetëm shtetësi shqiptare, që gëzon cilësi të larta profesionale dhe morale, dhe që plotëson këto kritere:

a) ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë të barasvlershme me "Master i shkencave", ose arsimin e lartë policor;

b) ka eksperiencë pune si prokuror, punonjës i Policisë së Shtetit apo Policisë Gjyqësore ose hetues i Byrosë Kombëtare të Hetimit;

c) ka përvojë pune të paktën 5 vjet në çështje që kanë të bëjnë me veprat penale në fushën e korrupsionit, krimit të organizuar apo krimeve të rënda;

ç) nëse ka qenë apo është punonjës i Policisë së Shtetit, të ketë mbajtur për jo më pak se 3 vjet gradën "Komisar", "Kryekomisar", "Drejtues" apo "Drejtues i Parë";

d) të mos jetë në hetim apo gjykim për një vepër penale, të mos ndodhet në kushtet e pazgjedhshmërisë në një funksion publik, sipas ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", të ndryshuar, si dhe të nënshkruajë formularin e vetëdeklarimit në zbatim të atij ligji;

dh) nuk ka mbajtur funksione politike në administratën publike ose funksione drejtuese në partitë politike të paktën gjatë dhjetë viteve të fundit përpara momentit të kandidimit;

e) ka marrë vlerësim maksimal për aftësitë e tij profesionale, etike dhe integritetin moral, nëse i është nënshtruar vlerësimeve të mëparshme, sipas legjislacionit në fuqi;

ë) ndaj tij nuk është marrë masa disiplinore e "shkarkimit nga detyra", ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi sipas legjislacionit në momentin e kandidimit;

f) të mos ketë qenë dhe të mos jetë bashkëpunëtor, informator ose agjent i ndonjë shërbimi inteligjent;

g) në periudhën 29.11.1944 - 2.7.1991 të mos ketë qenë anëtar ose kandidat i Byrosë Politike, anëtar i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, anëtar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, Kryetar i Gjykatës së Lartë, Prokuror i Përgjithshëm, Kryetar i Hetuesisë së Përgjithshme, anëtar i Këshillit të Ministrave, kryetar i degëve të punëve të brendshme, punonjës i organeve të ish-Sigurimit të Shtetit, bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit apo i favorizuar, anëtar i Komisionit Qendror të Dëbim-Internimeve, hetues, prokuror, gjyqtar në procese politike, denoncues apo dëshmitar i akuzës në proceset politike të posaçme;

gj) të japë pëlqimin për t'iu nënshtruar testit të poligrafit. Informacioni në raportin e përgatitur nga specialisti i poligrafit mbahet në konsideratë gjatë procesit të përzgjedhjes.

3. Procedura e përzgjedhjes së Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit garanton kandidimin e hapur, konkurrimin e ndershëm midis shumë kandidatëve, vlerësimin objektiv të përmbushjes së kushteve dhe kritereve, transparencën dhe standardet e tjera të procesit të rregullt ligjor. Përmbushja e kushteve dhe kritereve të përcaktuara në këtë nen provohet me dokumentacionin shoqërues të kërkesës, të depozituar nga kandidati, si dhe informacioneve zyrtare të marra nga institucione të tjera publike, përfshirë edhe informacionet konfidenciale në lidhje me kandidatët.

Neni 35
**Lirimi, shkarkimi ose pezullimi nga detyra i Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit**

1. Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit lirohet nga detyra nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, kur:

a) i përfundon mandati;

b) jep dorëheqjen;

c) mbush moshën e pensionit.

2. Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit shkarkohet nga detyra nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në rekomandimet e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, kur:

a) dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale;

b) për shkelje të Kushtetutës apo për shkelje të rëndë të ligjit gjatë kryerjes së detyrës;

c) për shkelje të rënda dhe shumë të rënda të disiplinës gjatë ushtrimit të funksioneve;

ç) kur dalin fakte të reja që janë verifikuar dhe janë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara për emërim.

3. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në rekomandimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, pezullon Drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit nëse ai bëhet subjekt i një hetimi penal. Pezullimi vazhdon për aq kohë sa do të ekzistojnë shkaqet e tij.

Neni 36

**Zëvendësdrejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit**

1. Zëvendësdrejtori është përgjegjës për funksionimin e shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Zëvendësdrejtori është përgjegjës për funksionimin e vazhdueshëm të Byrosë Kombëtare të Hetimit gjatë çdo mungese të drejtorit.

2. Zëvendësdrejtori është hetues i Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe ka të paktën 3 vjet eksperiencë pune në hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar apo krimeve të rënda, si dhe duhet të ketë treguar aftësi drejtuese.

3. Zëvendësdrejtori emërohet nga Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit, me pëlqimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, pas një procesi të hapur dhe transparent të përzgjedhjes, me mandat 4-vjeçar dhe me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

4. Zëvendësdrejtori, pas mbarimit të mandatit, gëzon të drejtën të kthehet në pozicionin e mëparshëm si hetues.

5. Zëvendësdrejtori raporton te Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit.

6. Zëvendësdrejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit shkarkohet nga detyra nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në rekomandimet e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, kur:

a) dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale;

b) për shkelje të Kushtetutës apo për shkelje të rëndë të ligjit gjatë kryerjes së detyrës;

c) për shkelje të rënda dhe shumë të rënda të disiplinës gjatë ushtrimit të funksioneve;

ç) kur dalin fakte të reja që janë verifikuar dhe janë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara për emërimin e tij.

7. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në rekomandimin e përbashkët të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, pezullon Zëvendësdrejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit nëse ai bëhet subjekt i një hetimi penal. Pezullimi vazhdon për aq kohë sa do të ekzistojnë shkaqet e tij.

Neni 37

**Hetuesi i Byrosë Kombëtare të Hetimit**

1. Hetuesi është punonjës i Byrosë Kombëtare të Hetimit, i cili është përgjegjës për hetimin. Ai gëzon statusin e oficerit të Policisë Gjyqësore dhe kryen hetime vetëm nën drejtimin e prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme.

2. Kandidati për hetues i Byrosë Kombëtare të Hetimit përzgjidhet pas një procesi rekrutimi, që mbështetet në praktikat më të mira të rekrutimeve konkurruese, të cilat parashikohen në një rregullore të hartuar dhe miratuar nga Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit, në përputhje me nenin 38 të këtij ligji.

3. Një kandidat mund të emërohet si hetues vetëm pasi të ketë përfunduar trajnimin përkatës dhe të ketë shfaqur aftësitë, që garantojnë kryerjen e detyrave sipas standardeve të kërkuara profesionale, në përputhje me nenin 38 të këtij ligji.

4. Emërimi i hetuesit në Byronë Kombëtare të Hetimit bëhet nga drejtori, me pëlqimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

5. Hetuesi caktohet nga Drejtori i Byronë Kombëtare të Hetimit ose Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme që të punojë me një prokuror të Prokurorisë së Posaçme. Hetuesi nuk mund të caktohet në një detyrë tjetër pa pëlqimin e prokurorit të posaçëm apo të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

Neni 38

**Kriteret për emërimin dhe largimin e hetuesit të Byrosë Kombëtare të Hetimit**

1. Kandidati për hetues në Byrosë Kombëtare të Hetimit duhet të plotësojë këto kritere:

a) është shtetas shqiptar;

b) ka arsim të lartë policor, në drejtësi apo kontabilitet, ose arsim të lartë në degë të tjera që kanë lidhje me misionin e Byrosë Kombëtare të

Hetimit, nga një universitet vendas apo i huaj;

c) ka një përvojë më shumë se 1-vjeçare pune në institucionet e zbatimit të ligjit ose në një fushë tjetër që lidhet me qëllimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit;

ç) të ketë plotësuar me sukses kriteret e përzgjedhjes dhe trajnimit për Byronë Kombëtare të Hetimit.

2. Të gjithë kandidatët për hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit duhet të kryejnë me sukses të gjitha fazat e mëposhtme të përzgjedhjes:

a) plotësimin e një aplikimi *online*, përfshirë një *curriculum vitae* elektronike dhe dokumentet mbështetëse, si dhe një deklaratë me shkrim mbi motivimin për t'u bërë pjesë e Byrosë Kombëtare të Hetimit;

b) një provim me shkrim e me gojë, ku përfshihen teste konjitive, të sjelljes dhe të arsyetimit logjik;

c) një provim të zgjeruar me shkrim që mat aftësitë e shkrimit të raporteve, si dhe nivelin e shkrimit e leximit;

ç) një intervistë nga një komision që mat aftësitë e komunikimit verbal, si dhe aftësinë për t'i komunikuar idetë me efiçencë;

d) një testim të aftësive fizike që mat forcën dhe rezistencën fizike;

dh) një hetim mbi verifikimin e figurës, i cili konfirmon se personi nuk është dënuar e nuk është shpallur më parë fajtor për vepra penale; dhe

e) të ketë dhënë pëlqimin për t'iu nënshtruar testit të poligrafit rreth integritetit të kandidatit. Informacioni në raportin e përgatitur nga specialisti i poligrafit merret në konsideratë gjatë procesit të emërimit dhe atij të riemërimit.

3. Kandidati i pranuar i nënshtrohet një regjimi rigoroz trajnimi dhe arsimimi, me një sërë modulesh vlerësimi që duhen kaluar përpara se të certifikohet. Pasi është certifikuar si i trajnuar dhe i aftë, kandidati konsiderohet hetues.

4. Kursi i trajnimit dhe arsimimit, standardet profesionale dhe sistemet e vlerësimit të Byrosë Kombëtare të Hetimit miratohen nga drejtori, me pëlqimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

5. Procedurat për shqyrtimin e procedimeve disiplinore dhe llojet e masave disiplinore përcaktohen në këtë ligj, si edhe në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore".

6. Të gjithë hetuesit janë të detyruar të marrin një notë kaluese në secilin prej testeve të përmendura në pikën 2, shkronjat "b" dhe "d", të këtij neni, si parakusht për t'iu rinovuar emërimi i tyre çdo dy vjet. Të gjithë hetuesit japin pëlqimin për t'iu nënshtruar një testi të poligrafit rreth integritetit çdo dy vjet. Informacioni në raportin e përgatitur nga specialisti i poligrafit merret në konsideratë gjatë procesit të riemërimit.

Neni 39

**Shërbimet e Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit**

1. Byroja Kombëtare e Hetimit ka në përbërje të saj shërbime të Policisë Gjyqësore. Qëllimi i tyre është të rrisin bashkëpunimin dhe komunikimin midis Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe institucioneve të tjera, si dhe të ndihmojnë në hetimet e Prokurorisë së Posaçme, që kryhen nga institucione të tjera.

2. Oficerët nga shërbimet e Policisë Gjyqësore konkurrojnë për të punuar pranë shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit për një periudhë pesëvjeçare. Gjatë këtij mandati, ata paguhen nga Byroja Kombëtare e Hetimit, raportojnë tek zëvendësdrejtori dhe do të vlerësohen nga Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit. Ata janë të pavarur prej institucionit të tyre dhe vendosen nën varësinë procedurale hetimore të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme. Në përfundim të këtij mandati, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dërgon vlerësimet tek institucioni prej të cilit ka ardhur oficeri i Policisë Gjyqësore. Oficeri i shërbimeve të Policisë Gjyqësore gëzon të drejtën të kthehet në pozicionin e mëparshëm ose të emërohet në një pozicion të të njëjtit nivel, me një gradë që i korrespondon atij funksioni.

3. Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit, sipas nevojave, me pëlqimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, përcakton numrin e pozicioneve të lira dhe kualifikimet për punonjësit e Shërbimeve të Policisë Gjyqësore. Byroja Kombëtare e Hetimit organizon një proces aplikimi të hapur dhe transparent, në përputhje me nenin 7, të këtij ligji, për punonjësit e kualifikuar të drejtorive të Policisë së Shtetit, përgjegjëse për hetimin e krimit të organizuar, krimit ekonomik, trafikimit të narkotikëve, si dhe sektorëve të tjerë përkatës, si dhe institucioneve të tjera përkatëse me funksione të Policisë Gjyqësore. Shpallja e pozicionit të lirë

përmban njoftimin se oficerët për në shërbimet e Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit duhet të përmbushin kriteret e parashikuara në nenin 6 dhe kreun VIII të këtij ligji. Aplikanti duhet të përmbushë kriteret e parashikuara në nenin 6 dhe kreun VIII, përpara se ai të caktohet apo emërohet pranë shërbimeve të Policisë Gjyqësore.

4. Oficerët e shërbimeve të Policisë Gjyqësore qëndrojnë në zyrat e institucioneve nga ku ata kanë ardhur ose në zyrat e Byrosë Kombëtare të Hetimit. Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit vendos për vendin se ku ata qëndrojnë.

5. Kur drejtori apo Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme e konsiderojnë të nevojshme, Byroja Kombëtare e Hetimit cakton hetues nga zyra e saj të vendosen pranë zyrave të Policisë së Shtetit ose institucioneve të tjera. Policia e Shtetit ose institucionet e tjera marrin përsipër të zbatojnë këtë vendim.

Neni 40

**Statusi i Policisë Gjyqësore**

1. Drejtori, Zëvendësdrejtori, hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe oficerët e shërbimeve të Policisë Gjyqësore janë oficerë të Policisë Gjyqësore. Në ushtrimin e funksioneve të tyre drejtohen dhe kontrollohen nga prokurorët e posaçëm.

2. Hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe oficerët e Policisë Gjyqësore të shërbimeve punojnë dhe komunikojnë drejtpërsëdrejti me prokurorët e posaçëm.

3. Punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit ruajnë sekretin e hetimeve penale, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 41

**Largimi i punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit**

1. Punonjësi i Byrosë Kombëtare të Hetimit, pas përfundimit të trajnimit të nevojshëm dhe emërimit në detyrë, shërben për një periudhë jo më pak se shtatë vjet në Byronë Kombëtare të Hetimit, përveç rasteve kur ai shkarkohet sipas parashikimeve të këtij neni.

2. Punonjësi i Byrosë Kombëtare të Hetimit shkarkohet nga drejtori, me pëlqimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, nëse:

a) është dënuar për një vepër penale nga një gjykatë penale në Shqipëri apo në ndonjë vend tjetër;

b) është vlerësuar nga një komision mjekësh ekspertë si i paaftë nga ana shëndetësore për të qenë anëtar i Byrosë Kombëtare të Hetimit për të përmbushur detyrat dhe funksionet e parashikuara nga ky ligj;

c) në përfundim të një procedure disiplinore, e cila e ka gjetur punonjësin e Byrosë Kombëtare të Hetimit në shkelje të rregullave të zbatueshme të sjelljes profesionale në më shumë se tri raste, dhe ai vlerësohet si i papërshtatshëm profesionalisht për të ushtruar detyrat e tij;

ç) punonjësi i Byrosë Kombëtare të Hetimit shkarkohet edhe kur dalin dhe vërtetohen fakte të reja, të panjohura më parë, të cilat kanë lidhje me arsimimin, kualifikimet apo besueshmërinë e punonjësit, ose të cilat kanë lidhje dhe janë në mospërputhje me kriteret për emërimin e tij.

Neni 42

**Oficeri përgjegjës për mbikëqyrjen**

1. Oficeri përgjegjës për mbikëqyrjen është një hetues i Byrosë Kombëtare të Hetimit me të paktën pesë vite përvojë si oficer i Policisë Gjyqësore.

2. Dy hetues emërohen me short për një mandat gjashtëmujor si oficer përgjegjës për monitorimin. Ky mandat nuk mund të përsëritet dy herë brenda një viti. Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit, në prani të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe Kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, bën përzgjedhjen me short.

3. Një oficer përgjegjës, sipas pikës 2, të këtij neni, kryen vëzhgimin periodik të telekomunikimeve të kryetarëve, gjyqtarëve dhe punonjësve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, drejtuesit, prokurorëve dhe punonjësve të Prokurorisë së Posaçme, Drejtorit, Zëvendësdrejtorit dhe hetuesve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, oficerëve të shërbimeve të Policisë Gjyqësore, si dhe punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Oficeri përgjegjës nuk ka përgjegjësi të tjera hetimore apo administrative.

4. Oficeri tjetër përgjegjës, sipas pikës 2, të këtij neni, kontrollon vëzhgimin periodik të kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, sipas nenit 50, të këtij ligji. Oficeri

përgjegjës ushtron gjithashtu edhe funksionin e ndërlidhësit me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

5. Çdo muaj, një prokuror i posaçëm përzgjidhet me short për të shërbyer si prokuror i posaçëm i gatshëm. Prokurori i posaçëm i gatshëm drejton, kontrollon dhe monitoron oficerin përgjegjës në detyrë. Oficeri përgjegjës raporton çdo informacion që ngre dyshime të arsyeshme për veprimtari korruptive apo kriminale te prokurori i posaçëm i gatshëm. Nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se prokurori i posaçëm është i përfshirë në veprimtarinë kriminale, atëherë oficeri përgjegjës i raporton cilitdo prej prokurorëve të posaçëm në Prokurorinë e Posaçme, i cili duket se nuk është i përfshirë në veprimtarinë e dyshimtë.

6. Oficeri përgjegjës, sipas pikës 3, të këtij neni, bën monitorim periodik të telekomunikimeve të pjesëtarëve të afërt të familjeve të personave të listuar në pikën 3 vetëm nëse:

a) ekziston dyshim i arsyeshëm se telefoni është përdorur nga personat e listuar në pikën 3 për të shmangur monitorimin periodik, apo për të shërbyer si ndërmjetës për njërin nga personat e listuar në pikën 3 të këtij neni;

b) monitorimi bëhet ndaj anëtarëve të afërt të familjes, të cilët kanë dhënë pëlqimin për monitorimin periodik, por jo ndaj anëtarëve të familjes nën 18 vjeç;

c) brenda 24 orëve përgatit një raport me shkrim që shpjegon bazat e dyshimit të arsyetuar dhe rezultatet e monitorimit të anëtarit të afërt të familjes dhe ia paraqet prokurorit të posaçëm të gatshëm. Nëse ai prokuror i posaçëm duket si i përfshirë në një veprimtari kriminale, atëherë, brenda 24 orëve, oficeri përgjegjës i raporton cilitdo prej prokurorëve të posaçëm pranë Prokurorisë së Posaçme, i cili duket se nuk është i përfshirë në veprimtarinë e dyshimtë;

ç) prokurori i posaçëm autorizon me shkrim vazhdimin e monitorimit të telefonit të pjesëtarit të afërt të familjes, nëse ekziston një dyshim i arsyeshëm se telefoni është përdorur nga personat e listuar në pikën 3 për të shmangur monitorimin periodik, apo për të shërbyer si ndërmjetës për njërin nga personat e listuar në pikën 3 të këtij neni.

7. Oficeri përgjegjës, sipas pikës 3, të këtij neni, informon prokurorin e posaçëm të gatshëm rreth informacionit që do të shërbejë si bazë për të arsyetuar një autorizim të gjykatës për përgjim.

8. Oficeri përgjegjës, sipas pikës 3, të këtij neni, ruan për një periudhë gjashtëmujore regjistra të telekomunikimeve, të cilat ngrenë dyshime të arsyeshme për veprimtari të papërshtatshme apo kriminale, por të gjitha regjistrimet apo shënimet e tjera i shkatërron brenda 3 ditëve. Një prokuror i posaçëm urdhëron me shkrim, ose gjykata kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar merr vendim me shkrim për ruajtjen e regjistrimeve që mund të ngrenë një dyshim të arsyeshëm për një aktivitet të papërshtatshëm ose kriminal.

9. Oficeri përgjegjës raporton shkelje të etikës së gjyqtarëve apo prokurorëve tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Neni 43

**Marrëdhëniet e Byrosë Kombëtare të Hetimit me struktura të tjera policore**

1. Drejtori është i autorizuar të firmosë marrëveshje me struktura të tjera policore për të përmirësuar efiçencën, kapacitetin operacional dhe shkëmbimin e informacionit.

2. Byroja Kombëtare e Hetimit bashkëpunon me Policinë e Shtetit, Shërbimin Informativ Shtetëror, Policinë Kufitare, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe të gjitha institucionet e tjera përkatëse shtetërore për të realizuar në mënyrë të plotë dhe efektive ushtrimin e funksioneve të përcaktuara në këtë ligj.

3. Byroja Kombëtare e Hetimit ka akses në informacionin që përmbajnë bazat e të dhënave, përfshirë Sistemin e Menaxhimit Total të Informacionit (TIMS).

4. Byroja Kombëtare e Hetimit është institucioni që ekzekuton urdhrat për përgjim të kërkuar nga Prokuroria e Posaçme dhe të autorizuara nga gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe ushtron detyra të tjera të parashikuara në pikat 3 dhe 6, të nenit 42, të këtij ligji, si dhe ka kapacitetet e veta për t'i kryer detyrat si më sipër.

KREU VI
PUNONJËSIT E GJYKATAVE KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE ORGANEVE TË SPECIALIZUARA TË STRUKTURËS SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Neni 44
**Statusi i punonjësve të shërbimit civil**

1. Punonjësit e administratës gjyqësore të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar u nënshtrohen dispozitave përkatëse të ligjit "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.
2. Punonjësit e administratës së prokurorisë pranë Prokurorisë së Posaçme u nënshtrohen dispozitave përkatëse të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", përveçse nëse parashikohet ndryshe në këtë ligj.

Neni 45
**Standardet e sjelljes së punonjësve**

Punonjësit e administratës gjyqësore të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, punonjësit e administratës të Prokurorisë së Posaçme dhe punonjësit e administratës të Byrosë Kombëtare të Hetimit u nënshtrohen këtyre kushteve të posaçme:
1. Janë të detyruar të bëjnë deklarim financiar vjetor në Inspektoratin e Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktin e Interesave. Mosdeklarimi ose deklarimi jo i plotë apo i rremë përbën shkak për pezullim të menjëhershëm dhe shkarkim të mundshëm.
2. Janë të detyruar t'i dorëzojnë oficerit përgjegjës të Byrosë Kombëtare të Hetimit deklaratën sipas shtojcës A. Punonjësit kanë detyrimin e vazhdueshëm të përditësojnë deklaratën, sipas nevojës dhe të deklarojnë çdo konflikt interesi te kancelari, te gjyqtari apo te prokurori përkatës. Mosdorëzimi apo mospërditësimi i deklaratës apo deklarimi jo i plotë apo i rremë përbën shkak për pezullim të menjëhershëm dhe shkarkim të mundshëm.
3. Kanë detyrimin e vazhdueshëm t'i deklarojnë drejtorit apo oficerit përgjegjës të Byrosë Kombëtare të Hetimit ose Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme çdo kontakt me persona, të cilët i kanosin, u ofrojnë ryshfet apo para për të marrë informacion ose në këmbim të veprimeve që kanë lidhje me një hetim apo çështje të zyrës. Mosdeklarimi i këtyre kontakteve ose deklarimi jo i plotë apo i rremë përbën shkak për pezullim të menjëhershëm dhe shkarkim të mundshëm.
4. Kanë detyrimin e vazhdueshëm të ruajnë konfidencialitetin dhe sekretin e dëshmitarëve, provave, dokumenteve dhe të çdo informacioni tjetër në lidhje me hetimet e zyrës, me përjashtim të rasteve kur këto informacione janë bërë publike në përputhje me ligjin. Shkelja e këtij detyrimi përbën shkak për pezullim të menjëhershëm dhe shkarkim të mundshëm.

KREU VII
SIGURIA E MJEDISEVE DHE PERSONELIT

Neni 46
**Siguria e mjediseve**

1. Policia e Shtetit garanton në mënyrë të vazhdueshme sigurinë e mjediseve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të Prokurorisë së Posaçme dhe të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Shërbimet e sigurisë të Policisë së Shtetit kryejnë detyrat e tyre nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e kryetarit të gjykatës përkatëse kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe të Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, respektivisht.
2. Rregullat e hollësishme mbi procedurat në lidhje me garantimin e sigurisë së këtyre institucioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 47
**Siguria e personelit**

1. Në zbatim të dispozitave përkatëse të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", gjyqtarëve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme dhe Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit u sigurohet mbrojtja personale sipas kërkesës, si më poshtë:
a) kryetarët e gjykatave, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit mbrohen me shoqërim, me oficer e nënoficer;

b) gjyqtarët dhe prokurorët me shoqërim, me oficer.

2. Nëse kërkohet përkatësisht nga kryetari i gjykatës apo Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, sigurohet mbrojtje për anëtarët e familjes, banesat dhe/ose eskortë për gjyqtarët dhe prokurorët.

3. Drejtorit, Zëvendësdrejtorit apo hetuesve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, si dhe anëtarëve të familjeve të tyre, për shkak të apo gjatë ushtrimit të detyrës, u sigurohet mbrojtje personale e jetës, shëndetit dhe pronës, nëse kërkohet nga Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit.

4. Rregullat e detajuara mbi procedurat e sigurisë, sipas kësaj dispozite, parashikohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Oficerët e caktuar për sigurinë e gjyqtarëve, prokurorëve, anëtarëve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, familjeve dhe banesave të tyre nuk zëvendësohen pa marrë paraprakisht miratimin e kryetarit të gjykatës, Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme apo Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

## KREU VIII
## KUSHTET E SIGURISË PËR BESIMIN DHE KONFIDENCIALITETIN

### Neni 48
### Heqja dorë nga të drejtat si kusht për caktimin në detyrë, emërimin dhe aksesin në informacion

1. Përpara emërimit, kandidatët për gjyqtarë dhe pozicione të tjera në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, kandidatët për prokurorë dhe pozicione të tjera në Prokurorinë e Posaçme, kandidatët për drejtor, zëvendësdrejtor, hetues, oficer të shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe pozicione të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimit firmosin deklaratën përkatëse me shkrim për heqjen dorë nga e drejta e tyre për pritshmëri për privatësi (jetë private) në telekomunikimet e tyre dhe në të dhënat financiare, të dhënë në shtojcat B1 e B2 të këtij ligji. Kjo deklaratë firmoset përpara se ata të caktohen me detyrë apo të punësohen.

2. Anëtarët e afërt të familjeve të personave të përmendur në pikën 1 gjithashtu firmosin deklaratën përkatëse për heqjen dorë nga të drejtat, të dhënë në shtojcën B3 të këtij ligji, si tregues se i kuptojnë kushtet.

3. Pas caktimit në detyrë apo punësimit, gjyqtarët dhe pozicionet e tjera në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, prokurorët dhe pozicionet e tjera në Prokurorinë e Posaçme, drejtori, zëvendësdrejtori, hetues, oficerë të shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe pozicione të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimit kanë nga një telefon celular, adresë poste elektronike dhe numër telefoni të dhënë nga gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar apo organet e strukturës së posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, dhe bien dakord të përdorin vetëm ato numra telefoni dhe adresa poste elektronike. Ata nuk lejohen të përdorin asnjë formë tjetër komunikimi elektronik. Numri i telefonit dhe adresa e postës elektronike i nënshtrohen kontrollit periodik nga oficeri përgjegjës i Byrosë Kombëtare të Hetimit.

4. Gjyqtarët dhe pozicionet e tjera në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, prokurorët dhe pozicionet e tjera në Prokurorinë e Posaçme, drejtori, zëvendësdrejtori, hetuesit, oficerët e shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe pozicione të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimit plotësojnë dhe nënshkruajnë deklaratën mbi llogaritë e tyre financiare, si dhe ato të anëtarëve të afërt të familjeve të tyre, të dhënë në shtojcën C të këtij ligji. Deklarata dorëzohet tek oficeri përgjegjës i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave. Llogaritë financiare i nënshtrohen kontrollit periodik nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave. Të gjitha llogaritë e reja deklarohen brenda 3 ditëve.

### Neni 49
### Kontrolli periodik

1. Llogaritë financiare të kryetarëve të gjykatave, të gjyqtarëve dhe punonjësve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të drejtuesit, prokurorëve të posaçëm dhe punonjësve të Prokurorisë së Posaçme, të drejtorit, zëvendës-drejtorit, hetuesve, oficerëve të shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe punonjësve të tjerë të Byrosë Kombëtare të Hetimit, si edhe të anëtarëve të afërt të familjeve të tyre vëzhgohen në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 50 të këtij ligji. Telekomunikimet e kryetarëve të gjykatave, gjyqtarëve, drejtuesit, prokurorëve, drejtorit, zëvendësdrejtorit, hetuesve, oficerëve të shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Byrosë

Kombëtare të Hetimit mbikëqyren në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 51 të këtij ligji.

2. Oficeri përgjegjës i Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave bashkërendojnë veprimtaritë e tyre dhe takohen, sipas nevojës, por jo më rrallë se një herë në muaj, për të diskutuar mbi veprimtari të dyshimta.

3. Oficeri përgjegjës i raporton prokurorit të posaçëm të gatshëm çdo informacion që mbështet një dyshim të arsyeshëm për korrupsion apo veprimtari kriminale. Nëse prokurori i posaçëm duket i përfshirë në veprimtarinë kriminale, atëherë oficeri përgjegjës i raporton cilitdo prej prokurorëve të posaçëm në Prokurorinë e Posaçme, i cili duket se nuk është i përfshirë në veprimtarinë e dyshimtë.

Neni 50

**Kontrollet dhe vëzhgimet që kryhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave cakton një punonjës të saj, në konsultim me Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, për të mbikëqyrur llogaritë financiare të kryetarëve, gjyqtarëve dhe punonjësve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të drejtuesit, prokurorëve dhe punonjësve të Prokurorisë së Posaçme, drejtorit, zëvendësdrejtorit, hetuesve dhe punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, oficerëve të Shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit, si dhe të anëtarëve të afërt të familjeve të tyre. Ky person është përgjegjës për kallëzimin e çdo vepre penale të mundshme dhe ka atributet e Policisë Gjyqësore. Ky pozicion i kalon një punonjësi tjetër me rotacion çdo dy vjet. Oficeri përgjegjës i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave mbikëqyret nga oficeri përgjegjës, sipas pikës 4, të nenit 42, të këtij ligji. Oficeri përgjegjës nuk ka përgjegjësi të tjera.

2. Oficeri përgjegjës kryen ruajtjen e të dhënave për gjashtë muaj dhe, në rast se nuk urdhërohet nga një prokuror i Prokurorisë së Posaçme t'i ruajë të dhënat për më gjatë, i shkatërron ato pas muajit të gjashtë. Ky person është përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me legjislacionin përkatës.

3. Oficeri përgjegjës shqyrton çdo muaj llogaritë financiare të kryetarëve, gjyqtarëve dhe punonjësve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të drejtuesit, prokurorëve të posaçëm dhe punonjësve të Prokurorisë së Posaçme, Drejtorit, Zëvendësdrejtorit, hetuesve dhe punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, oficerëve të Shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit, si dhe të anëtarëve të afërt të familjeve të tyre.

4. Oficeri përgjegjës ka akses te deklarimet e pasurive dhe të lidhjeve, të bëra prej kryetarëve, gjyqtarëve dhe punonjësve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të drejtuesit, prokurorëve të posaçëm dhe punonjësve të Prokurorisë së Posaçme, Drejtorit, Zëvendësdrejtorit, hetuesve dhe punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, oficerëve të shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Ai ka edhe bashkëpunimin e Shërbimit Informativ Shtetëror.

5. Oficeri përgjegjës i raporton prokurorit të posaçëm të gatshëm çdo informacion që mbështet një dyshim të arsyeshëm lidhur me indiciet e mëposhtme. Nëse prokurori i posaçëm duket i përfshirë në veprimtarinë kriminale, atëherë oficeri përgjegjës i raporton cilitdo prej prokurorëve të posaçëm në Prokurorinë e Posaçme, i cili duket se nuk është i përfshirë në veprimtarinë e dyshimtë:

a) transaksione të mëdha financiare;

b) modele të pazakonta transaksionesh financiare;

c) transaksione financiare nga burime të pazakonta apo kriminale;

ç) ekzistencë llogarish financiare, të cilat nuk janë deklaruar.

Neni 51

**Kontrollet dhe vëzhgimet që kryhen nga Byroja Kombëtare e Hetimit**

1. Oficeri përgjegjës në Byronë Kombëtare të Hetimit krijon një plan për shqyrtimin çdo muaj të komunikimeve telefonike, mesazheve apo postës elektronike të kryetarëve, gjyqtarëve dhe punonjësve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të drejtuesit, prokurorëve dhe punonjësve të Prokurorisë së Posaçme, dhe të drejtorit, zëvendësdrejtorit, hetuesve, oficerëve të shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe punonjësve

të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Ky plan nuk u bëhet i ditur kryetarëve të gjykatave, gjyqtarëve, drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, prokurorëve të posaçëm, Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit apo kujtdo tjetër. Plani ndryshohet çdo tre muaj.

2. Oficeri përgjegjës ka akses në deklarimet e pasurive dhe të lidhjeve, të bëra prej kryetarëve, gjyqtarëve dhe punonjësve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të drejtuesit, prokurorëve dhe punonjësve të Prokurorisë së Posaçme, drejtorit, zëvendësdrejtorit, hetuesve, oficerëve të shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Ai bashkëpunon edhe me Shërbimin Informativ Shtetëror.

3. Oficeri përgjegjës, nëse ka dyshim të arsyeshëm se një telefonatë, mesazh apo komunikim me postë elektronike është provë e korrupsionit, nxjerrjes së informacionit, komunikimit me organizata kriminale, ndikimit politik apo çfarëdo veprimi tjetër që mund të jetë në shkelje të Kodit Penal, ai ia raporton atë një prokurori të posaçëm të Prokurorisë së Posaçme, i cili nuk është i përfshirë në shkelje.

4. Oficeri përgjegjës i ruan të dhënat për 2 muaj dhe, në rast se nuk urdhërohet nga një prokuror i Prokurorisë së Posaçme t'i ruajë të dhënat për më gjatë, i shkatërron ato pas muajit të dytë. Ky person është përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me legjislacionin përkatës.

5. Oficeri përgjegjës nuk dëgjon telefonatat që shkelin të drejtën për jetë private të personave që nuk kanë dhënë miratim paraprak për vëzhgimin. Nëse oficeri përgjegjës ka dyshim të arsyeshëm se ka ndodhur apo do të ndodhë një vepër penale dhe se vëzhgimi i asaj telefonate me persona që nuk kanë dhënë miratim paraprak do të japë prova për këtë vepër penale, ai do të kontaktojë menjëherë një prokuror të posaçëm të papërfshirë në shkelje për të marrë autorizim nga gjykata.

Neni 52
**Mbrojtja e të dhënave**

Të dhënat personale ruhen dhe përpunohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 53
**Raportimi i informacionit dhe provave**

1. Çdo person, përfshirë oficerët përgjegjës të Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, kanë të drejtën të raportojnë informacion apo prova të një shkeljeje të kryer nga një kryetar ose gjyqtar i gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, prokuror i Prokurorisë së Posaçme, drejtor, zëvendësdrejtor, hetues, oficer i shërbimeve të Policisë Gjyqësore ose pozicione të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimit, ose nga një punonjës te një prokuror i Prokurorisë së Posaçme, i cili nuk është i përfshirë në shkelje.

2. Bazuar në një raport, në përputhje me pikën 1, të këtij neni, një prokuror i Prokurorisë së Posaçme nis një hetim kundër kryetarit ose secilit gjyqtar të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, drejtuesit ose prokurorit të Prokurorisë së Posaçme, drejtorit, zëvendësdrejtorit, hetuesve, oficerëve të shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe pozicioneve të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimit, ose punonjësve, pa kërkuar miratim nga ndonjë autoritet tjetër.

Neni 54
**Shkarkimi për shkeljen e kushteve të besimit dhe konfidencialitetit**

1. Kur ka prova se një kryetar ose një gjyqtar i gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, një drejtues ose prokuror i Prokurorisë së Posaçme ka nxjerrë informacion sensitiv, qoftë nga pakujdesia apo me qëllim, ai person mund të shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor apo Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

2. Kur ka prova se një punonjës i gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Prokurorisë së Posaçme, ose drejtori, zëvendësdrejtori, hetuesit, oficerët e shërbimeve të Policisë Gjyqësore ose punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit ka nxjerrë informacion sensitiv, qoftë nga pakujdesia apo me qëllim, ai person mund të shkarkohet.

Neni 55
**Aktet nënligjore**

1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ky ligj, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit hartojnë

dhe miratojnë aktet nënligjore në përputhje me këtë ligj brenda dy muajve nga momenti i krijimit dhe funksionimit të këtyre strukturave.

2. Këshilli i Ministrave, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ngarkohet të nxjerrë aktet nënligjore në përputhje me përcaktimet e pikës 2, të nenit 46, dhe pikës 4, të nenit 47, të këtij ligji.

KREU IX
BUXHETI

Neni 56
**Buxheti për Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar**

1. Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka një buxhet të pavarur që është pjesë e buxhetit të shtetit dhe parashikohet në një zë të veçantë të tij.

2. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme harton projektbuxhetin e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

3. Buxheti i Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në të cilin përfshihet buxheti i Prokurorisë së Posaçme, buxheti i Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe buxheti i shërbimit të oficerëve të Policisë Gjyqësore, hartohet dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin përkatës të menaxhimit buxhetor e financiar.

4. Në rastin kur propozimi i projektbuxhetit të Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar nga Këshilli i Ministrave është i ndryshëm nga projektbuxheti i propozuar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, ky i fundit ka të drejtë të marrë pjesë në procedurat parlamentare për të mbrojtur projektbuxhetin e propozuar.

5. Në buxhetin e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar mund të përfshihen edhe të ardhura të tjera të ligjshme, përfshirë fonde nga donatorë ndërkombëtarë, të cilët nuk janë në konflikt interesi me veprimtarinë e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

6. Fondet e marra në përputhje me pikën 5, të këtij neni, duhet të përdoren në përputhje me marrëveshjet e lidhura me donatorin ndërkombëtar dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi.

KREU X
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 57
**Dispozita kalimtare**

1. Dispozitat kalimtare për gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda parashikohen në zbatim të dispozitave përkatëse të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

2. Dispozitat kalimtare për prokurorët e Prokurorisë për Krimet e Rënda parashikohen në zbatim të dispozitave përkatëse të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

3. Gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokuroria e Posaçme vendosen në ndërtesën aktuale të Gjykatës për Krimet e Rënda dhe Prokurorisë për Krimet e Rënda.

4. Byrosë Kombëtare të Hetimit i sigurohet një mjedis i përshtatshëm pune dhe pajiset brenda katër muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

5. Deri në fillimin e funksionimit të Prokurorisë së Posaçme, kompetenca e saj për të ushtruar ndjekjen penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq, për veprat penale apo subjektet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 135, të Kushtetutës, ushtrohet përkatësisht nga Prokuroria e Përgjithshme, prokuroritë e rretheve gjyqësore apo Prokuroria e Krimeve të Rënda, sipas kompetencës dhe juridiksionit të parashikuar nga legjislacioni në fuqi përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar". Ditën e fillimit të funksionit të Prokurorisë së Posaçme, çështjet nën hetim apo gjykim i transferohen menjëherë për ndjekje kësaj prokurorie.

6. Në mënyrë që të respektohet e drejta e të pandehurve për një gjykim të drejtë, çështjet që do të jenë në gjykim para gjykatave për krimet e rënda në ditën e 300-të pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, mbeten nën kompetencën e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, edhe nëse ato nuk bëjnë pjesë në kompetencën parësore apo dytësore të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, sipas këtij ligji. Këto çështje ndiqen penalisht nga Prokuroria e Posaçme.

7. Në mesnatën e ditës së 300-të pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, kompetencat e parashikuara nga nenet 8 dhe 9, të këtij ligji, u kalojnë gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokurorisë së Posaçme.

8. Ligji nr. 9110, datë 24.7.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krimet e rënda", shfuqizohet në mesnatën e ditës së 300-të pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

9. Një komision i përbërë nga ekspertë të drejtësisë penale, të caktuar nga misionet e Bashkimit Europian dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, do të japë udhëzime dhe këshilla për themelimin dhe zhvillimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit, për një periudhë 2-vjeçare, duke nisur nga momenti i themelimit të kësaj Byroje. Komisioni i Pavarur i Rishikimit vëzhgon në mënyrë aktive procesin e rekrutimit dhe trajnimit të punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, si dhe miraton materialet e trajnimit të hetuesve dhe Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

10. Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka buxhet fillestar të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave dhe të miratuar me ligj të posaçëm për buxhetin. Të gjitha buxhetet e mëvonshme përcaktohen në përputhje me nenin 56 të këtij ligji.

11. Përjashtimisht nga rregulli i parashikuar në pikën 6, të nenit 6, dhe pikën 2, të nenit 12, të këtij ligji, për një periudhë 4-vjeçare nga hyrja në fuqi e këtij ligji, kontrolli i verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve për gjyqtarë në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar ose prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, si dhe familjarëve të afërt të tyre, bëhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit, sipas nenit 179/b, të Kushtetutës, dhe ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të funksionarëve të sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë". Një gjyqtar apo prokuror, që ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, konsiderohet se e përmbush kushtin e sigurisë, të parashikuar në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 6, të këtij ligji. Vetëm pas kalimit me sukses të procesit të rivlerësimit, me vendim përfundimtar, ata mund të kualifikohen për t'u përzgjedhur si gjyqtar në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar ose prokuror në Prokurorinë e Posaçme.

12. Përjashtimisht nga rregulli i parashikuar në pikën 5, të nenit 6, për një periudhë 2-vjeçare nga hyrja në fuqi e këtij ligji, rolin e Komisionit të Posaçëm lidhur me verifikimin e pasurisë dhe figurës për kandidatët për nëpunës civilë gjyqësorë në gjykatat e posaçme, personel administrativ në Prokurorinë e Posaçme, për Drejtor dhe për hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit, si dhe familjarët e afërm të tyre, e luan Komisioni i Posaçëm i përbërë nga:

a) dy prokurorë të Prokurorisë së Posaçme, të zgjedhur me short. Procesi i përzgjedhjes me short monitorohet nga Avokati i Popullit; dhe

b) një gjyqtar të gjykatave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, i zgjedhur me short. Procesi i përzgjedhjes me short monitorohet nga Avokati i Popullit.

13. Komisioni i Posaçëm, i ngritur sipas pikës 12, të këtij neni, e ushtron veprimtarinë e tij në bazë të pikës 6, të nenit 6, dhe nenit 7 të këtij ligji.

Neni 58

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 6.10.2016

**Shpallur me dekretin nr. 9768, datë 18.10.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**ANEKSI A**
**DEKLARATA PËR KONTROLLIN E FIGURËS**

Ky dokument pranohet vetëm nëse:

- Është plotësuar nga vetë subjekti i rivlerësimit, në dorëshkrim, me shkronja kapitale dhe pa korrigjime
- Nuk ka rubrika të paplotësuara, ose vendoset shënimi " nuk aplikohet" në rastet e nevojshme;
- Subjekti i rivlerësimit shkruan emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin në vendin e caktuar në fund te çdo faqeje;

**PJESA 1 - Subjekti i rivlerësimit**

**A. Të dhënat aktuale identifikuese**

| | |
|---|---|
| Emri | |
| Emri i babait | |
| Mbiemri | |
| Gjinia | |
| Data/muaji/ viti i lindjes | |
| Vendi i lindjes | |
| Shteti i lindjes | |
| Shtetësia | |
| Numri personal si shënohet në kartën e identitetit | |

**B. Të dhëna identifikuese të përdorura më parë**

| | | |
|---|---|---|
| Emri | | |
| Emri i babait | | |
| Mbiemri | | |
| Gjinia | | |
| Data/muaji/ viti i lindjes | | |
| Vendi i lindjes | | |
| Shteti i lindjes | | |
| Shtetësia | | |
| Numri personal si shënohet në kartën e identitetit | | |

**C. Statusi civil:**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| i/e pamartuar | i/e martuar | i/e divorcuar | i/e ve | Bashkëjetues/e |

**Ç. Pasaporta dhe karta e identitetit:**

| | Numri i dokumentit | Data e lëshimit | | | Data e skadimit | | | Vendi i lëshimit | Autoriteti lëshues |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | data | muaji | viti | data | muaji | viti | | |
| Passport | | | | | | | | | |
| ID – Identity Card | | | | | | | | | |

**D. A keni adresë e-mail?**

Jo □

Po □» Jepni adresën zyrtare të e-mailit, e cila do të përdoret për qëllim njoftimi gjatë procesit;

Ju lutem jepni të gjithë adresat e tjera alternative të e-mailit;

**DH. A keni numër telefoni fiks?**

Jo □

Po □» Jepni numrin e telefonit së bashku me prefiksin;

**E. Numri/at e celularit që përdorni:**

## Pjesa 2- Të dhëna për vendin e banimit

**A. Jepni informacion të saktë mbi adresën/at tuaja:**

- Jepni adresën e plotë të vendbanimit aktual:
- A keni adresë tjetër vendbanimi? (adresë postare etj.)

Jo □

Po □» Jepni detaje

Adresa:

**B. Historiku i adresave tuaja të banimit, e fundit duke filluar nga 1.1.2012 (sipas rendit kronologjik):**

*Përfshihen:*

- *Adresat tuaja brenda apo jashtë Shqipërisë;*
- *Adresat e vendeve në të cilat keni jetuar për arsye studimesh/pune;*
- *Adresa të tjera tek të cilat keni jetuar përkohësisht;*

Vendosni të gjithë historikun tuaj të adresave pa lënë periudha kohore boshe:

| Data e fillimit | | Data e largimit | | Adresa e plotë (nr. i shtëpisë, emri i rrugës, qyteti, rrethi, qarku, njësia bashkiake, kodi postar) | Vendi/shteti |
|---|---|---|---|---|---|
| Muaji | Viti | Muaji | Viti | | |
| __/___ | | Aktualisht | | | |
| __/___ | | __/___ | | | |
| __/___ | | __/___ | | | |
| __/___ | | __/___ | | | |
| __/___ | | __/___ | | | |

Pjesa 3 -Të dhënat për arsimimin dhe kualifikimet

**A. Jepni detaje për arsimimin dhe të gjitha kualifikimet e kryera duke filluar nga shkolla e mesme:**

*Edukimi apo kualifikimet përfshijnë:*

- *shkollën e mesme*
- *shkollat verore*
- *specializimet, trajnimet e ndryshme*
- *kualifikimet e aftësisë*

*-teza/kërkime pasuniversitare*

| Data e fillimit | | Data e përfundimit | | Emri i plotë i institucionit ku keni ndjekur studimet (nuk lejohet përdorimi i shkurtimeve) | Titulli i fituar apo teza e mbrojtur | Gjendja | Adresa e plotë e institucionit | Vendi/shteti |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Muaji | Viti | Muaji | Viti | | | | | |
| ___/____ | | Aktualisht | | | | □ përfunduar □ papërfunduar □ ndërprerë | | |
| ___/____ | | ___/____ | | | | □ përfunduar □ papërfunduar □ ndërprerë | | |
| ___/____ | | ___/____ | | | | □ përfunduar □ papërfunduar □ ndërprerë | | |
| ___/____ | | ___/____ | | | | □ përfunduar □ papërfunduar □ ndërprerë | | |

**Pjesa 4 - Të dhëna për punësimin**

**A. Jepni detaje për punësimin dhe për periudhën e papunësisë gjatë duke filluar nga 1.1.2012 pa lënë hapësira kohore të papërfshira:**

*Periudha punësimit përfshin:Periudha e papunësisë përfshin:*
*- Te gjithë periudhën e paguar të punësimit - të gjitha hapësirat apo pauzat ndërmjet punësimit*
*- Vetëpunësimit/biznesit familjar, personal*
*- Interships*
*- Punë të papagueshme/vullnetare*

*Nëse nuk keni punuar asnjëherë shkruani "Nuk Aplikohet"*

| Data e fillimi | | Data e përfundimit | | Institucioni/Operatori Ekonomik | Funksioni | Emri dhe mbiemri i punëdhënësit apo eprorit të drejtpërdrejtë | Adresa e plotë e institucionit | Arsyeja e largimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Muaji | Viti | Muaji | Viti | | | | | |
| ___/____ | | Aktualisht | | | | | | |
| ___/____ | | ___/____ | | | | | | |
| ___/____ | | ___/____ | | | | | | |
| ___/____ | | ___/____ | | | | | | |
| ___/____ | | ___/____ | | | | | | |

**Pjesa 5-Të dhëna rreth familjarëve dhe personave të afërt:**

**A-Emri i plotë i bashkëshortit/ bashkëshortes, Datëlindja, Vendlindja, Adresa aktuale, Punësimi aktual.**

| Emri | Datëlindja | Vendlindja | Adresa aktuale | Punësimi aktual |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |

**B-Fëmijët: Emrat e plotë, Datëlindjet, Vendlindjet, Adresat aktuale, Punësimi aktual.**

| Emri | Datëlindja | Vendlindja | Adresa Aktuale | Punësimi aktual |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

**C-Babai: Emri i plotë, Datëlindja, Vendlindja, Adresa aktuale, Punësimi aktual.**

| Emri | Datëlindja | Vendlindja | Adresa Aktuale | Punësimi aktual |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |

**Ç-Nëna: Emri i plotë, Datëlindja, Vendlindja, Adresa aktuale, Punësimi aktual.**

| Emri | Datëlindja | Vendlindja | Adresa Aktuale | Punësimi aktual |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |

**D-Të afërmit (vëllezërit, motrat, të afërm si rrjedhojë e lidhjeve martesore, nipër/ mbesa, gjyshërit, teze/ halla, dajë/ xhaxhai, kushërinj të parë, kushërinj të dytë): Emri i plotë, Datëlindja, Vendlindja, Adresa aktuale, Punësimi aktual.**

| Emri | Datëlindja | Vendlindja | Adresa Aktuale | Punësimi aktual |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

**Pjesa 6-Të dhëna për sigurinë:**

**A-A jeni apo keni qenë të përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar?**

Po □Jo □

Nëse po ju lutem jepni shpjegime;

**B-A keni dijeni se një nga anëtarët e familjes tuaj është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar?**

Po □Jo □

**C-Nëse po, ju lutem jepni të dhënat e identitetit të familjarit tuaj, lidhjen tuaj familjare dhe të dhëna për veprat penale për të cilat është hetuar ose/dhe akuzuar, gjatë 10 viteve të fundit, nëse afate të tjera nuk janë parashikuar në ligjin për dekriminalizimin;**

*Me termin "familjar" do të kuptohet bashkëshortja/bashkëshorti i tij , i afërti deri në shkallë të katërt ose krushqi deri në shkallë të dytë, personi i lidhur me detyrime birësimi ose që bashkëjeton në mënyrë të përhershme me njërën nga palët;*

**Ç-A keni qenë ndonjëherë i ndaluar, i arrestuar, i dënuar për shkelje ligjore brenda ose jashtë shtetit?**

Po □Jo □

Nëse po ju lutem jepni shpjegime:

**D- A keni pasur kontakte të papërshtatshme në formën e një telefonatë, telekomunikim, takime, aktiviteti, vakti ose raste të tjera, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, të cilat nuk janë në pajtim me ushtrimin e detyrës?**

Po □Jo □

- Nëse po, ju lutem jepni të dhënat e identitetit të personit, lidhjen tuaj me të dhe të dhëna për veprat penale për të cilat është hetuar ose/dhe akuzuar.

**DH- Rendisni më poshtë takime, marrëdhënie ose kontakte të papërshtatshme me persona, të cilët në dijeninë tuaj, kanë qenë ose janë të arrestuar, të dënuar, apo të akuzuar publikisht për përfshirje në krimin e organizuar në ushtrimin e detyrës suaj të cilat nuk janë në pajtim me ushtrimin e detyrës?**

Po □Jo □

Nëse po ju lutem jepni shpjegime;

**E-A keni pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar?**

Po □Jo □

Nëse po, ju lutem jepni shpjegime;

**Ë- Listoni më poshtë të gjitha shtetet në të cilat keni qenë gjatë 5 viteve të fundit, si dhe datat e përafërta të këtyre udhëtimeve:**

| Data | | Destinacioni | Qëllimi |
|---|---|---|---|
| Prej | Në | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**F-Listoni më poshtë të gjitha shtëpitë, apartamentet, shtëpitë e pushimit, automjetet, motoçikletat, anijet ose aeroplanët e të cilëve, kandidati, është pronar apo i gëzon* gjatë 5 viteve të fundit, dhe që nuk përfshihen në objektet të cilat përdoren me qëllim zyrtar ushtrimin e detyrës.**

| Në pronësi/ gëzim/ përdorim | | Objekti | Qëllimi |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

*(“**E drejta e një personi për të gëzuar një send që është në pronësi të një tjetri, me detyrim që ta ruajë e ta mirëmbajë atë.**” **Përfshirja e përkufizimi i gëzimit të sendit sipas Kodit Civil**)*

*Shënim: Në rast se nevojitet mund të përdorni letër shtesë.*

**D E K L A R A T Ë**

Deklaroj se të dhënat e paraqitura në deklaratën për kontrollin e figurës janë të sakta dhe të vërteta. Jam i vetëdijshëm se mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaratës për kontrollin e figurës mund të pasjellë shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

________ më ___/___/____

**Emër Atësi Mbiemër**
**Nënshkrimi**

**D E K L A R A T Ë**

Për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e kontrollit të figurës dhe aksesin për njohjen dhe administrimin e të dhënave personale

Unë _________________________, i biri i/e bija e________________ dhe i/e ___________ , i/e vitlindjes ______________, lindur në ___________________dhe banues/banuese në _______________, me kombësi ____________ dhe shtetësi ______________, aktualisht me punë pranë _________________________, me detyrë_____________________________, me vullnetin tim te lirë;

**DEKLAROJ SE:**

- Jap pëlqimin që të mblidhen të dhëna dhe të kryhet procedura e kontrollit të figurës.
- Jam dakord që të dhënat e mia personale të deklaruara në "Formularin e Kontrollit të Figurës", të trajtohen nga personat përgjegjës për trajtimin e të dhënave personale për qëllimet e ligjshme.
- Jam i ndërgjegjshëm se mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaratës për kontrollin e e figurës mund të pasjellë shkarkimin nga detyra i subjektit të rivlerësimit sipas legjislacionit në fuqi.

_________ më ___/___/____

**Emër Atësi Mbiemër**
**Nënshkrimi**

**Shtojca B**
**Deklarata 1**

**VETË DEKLARIM**
**(i gjyqtarëve dhe prokurorëve)**

Unë________________________, i biri/ e bija e__________________ dhe i/e ________________, i/e datëlindjes__________________, lindur në_______________ dhe banues/ banuese në_____________, me kombësi_______________ dhe shtetësi___________, aktualisht i/e punësuar/emëruar pranë________________, me detyrë_______________, me vullnetin tim të lirë;

**DEKLAROJ SE:**

-Jam i informuar se do të caktohem me detyrë në një post që duhet të ketë besimin e posaçëm të publikut.

- Jam i informuar dhe jam dakord se do të marr një telefon fiks zyrtar, një telefon celular, një numër celular dhe një adresë poste elektronike. Jam i informuar dhe jam dakord të bëj të ditur çdo numër tjetër telefoni dhe adresë e-mail personale. Jam dakord të përdor vetëm këto mjete komunikimi elektronik. Nëse gjatë një emergjence do të më duhet të përdor një mjet tjetër komunikimi elektronik, do t'ia raportoj këtë fakt Oficerit Përgjegjës të Byrosë Kombëtare të Hetimit brenda 3 ditësh. Jam i informuar dhe jam dakord që këta numra telefoni dhe adresa të postës elektronike t'i nënshtrohen vëzhgimit nga Byroja Kombëtare e Hetimit, ku përfshihet leximi i e-maileve, mesazheve tekst si dhe dëgjimi i bisedave.

- Jam i informuar dhe jam dakord të deklaroj llogaritë e mia financiare si dhe të deklaroj çdo llogari të re që mund të krijoj. Jam i informuar dhe dakord që këto llogari do të vëzhgohen nga Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave.

- Jam i informuar dhe jam dakord që nëse nuk i respektoj këto kushte, mund të përballem me masa disiplinore ndër të cilat mund të jetë ndërprerja e mandatit tim. Jam i informuar gjithashtu se informacioni i përftuar nga vëzhgimi mund të çojë në ndjekje penale, nëse ka prova për një vepër penale.

- Jam i informuar dhe dakord se këto kushte janë të rëndësishme dhe në përpjesëtim të drejtë me nevojën për të kryer hetime, ndjekje penale dhe gjykime çështjesh të rëndësishme pa u ndikuar nga ndërhyrjet korruptive.

- Gjithashtu jam dakord që, në këmbim të këtyre kushteve, të kompensohem me një pagesë shtesë.

_________, më ___.___.20___

**DEKLARUESI**

(________________________)

**Shtojca B**
**Deklarata 2**

**VETËDEKLARIM**
**(i Kandidatëve për Pozicione të tjera në Prokurorinë e Posaçme, Kandidatët për Drejtor, Zëvendës Drejtor, Hetues, Oficer i Shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe Pozicione të Tjera në Byronë Kombëtare të Hetimi dhe Punonjësit e Gjykatave Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar)**

Unë___________________, i biri/ e bija e______________ dhe i/e _____________, i/e datëlindjes____________, lindur në_______________ dhe banues/ banuese në_____________, me kombësi_________ dhe shtetësi ___________, aktualisht i/e punësuar/emëruar pranë_______________, me detyrë _______________, me vullnetin tim të lirë;

**Deklaroj se:**

-Jam i informuar se do të caktohem me detyrë në një post që duhet të ketë besimin e posaçëm të publikut. Jam i informuar dhe jam dakord që gjatë punësimit tim të marr një telefon zyrtar fiks, një telefon celular, një numër celulari dhe një adresë poste elektronike. Jam i informuar dhe jam dakord të bëj të ditur çdo numër telefoni dhe adresa e-mail personale. Jam dakord të përdor vetëm këto mjete komunikimi elektronik. Nëse gjatë një emergjence do të më duhet të përdor një mjet tjetër komunikimi elektronik, do t'ia raportoj këtë fakt Oficerit Përgjegjës të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Jam i informuar dhe dakord që këta numra telefoni dhe adresa të postës elektronike t'i nënshtrohen vëzhgimit nga Oficeri Përgjegjës i Byrosë Kombëtare të Hetimit, ku përfshihet leximi i e-maileve, mesazheve tekst si dhe dëgjimi i bisedave.

- Jam i informuar dhe dakord për të deklaruar llogaritë e mia financiare si dhe për të deklaruar çdo llogari të re që mund të krijoj. Jam i informuar dhe dakord që këto llogari do të vëzhgohen nga Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave.

- Jam i informuar dhe dakord që nëse nuk i respektoj këto kushte, mund të përballem me masa disiplinore ndër të cilat mund të jetë ndërprerja e mandatit tim. Jam i informuar gjithashtu se informacioni i përftuar nga vëzhgimi mund të çojë në ndjekje penale, nëse ka prova për një vepër penale.

- Jam i informuar dhe dakord se këto kushte janë të rëndësishme dhe në përpjesëtim të drejtë me nevojën për të kryer hetime, ndjekje penale dhe gjykime çështjesh të rëndësishme pa u ndikuar nga ndërhyrjet korruptive.

________, më ___.___.20___

**DEKLARUESI**
(________________________)

**Shtojca B**
**Deklarata 3**

**VETË DEKLARIM**
**(i anëtarëve të familjes së gjyqtarëve dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; i prokurorëve dhe punonjësve të tjerë të Prokurorisë së Posaçme; i drejtorit, zëvendës drejtorit, hetuesit, oficerit të Shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe pozicioneve të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimi)**

Unë,___________________, anëtar i afërt i familjes së ________________ (_________________)[1], i/e datëlindjes___________, lindur në______________ dhe banues/ banuese në____________, me kombësi________ dhe shtetësi __________, aktualisht i/e punësuar/emëruar pranë______________, me detyrë______________, me vullnetin tim të lirë;

**Deklaroj se:**

- Jam i informuar se jam një anëtar i afërt i familjes së një personi i/e cili/cila do të caktohet me detyrë në një post që duhet të ketë besimin e posaçëm të publikut. Jam i informuar dhe jam dakord që gjatë punësimit të tij/saj telefonat e mi celularë dhe adresat e mia të postës elektronike do t'i bëhen të ditura (deklarohen) Oficerit Përgjegjës të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Jam i informuar dhe dakord që numrat e mi të telefonit dhe adresat e mia të postës elektronike do t'i nënshtrohen vëzhgimit nga Oficeri Përgjegjës i Byrosë Kombëtare të Hetimit, ku përfshihet leximi i e-maileve, mesazheve tekst si dhe dëgjimi i bisedave.
- Jam i informuar dhe dakord për të deklaruar llogaritë e mia financiare si dhe për të deklaruar çdo llogari të re që mund të krijoj. Jam i informuar dhe dakord që këto llogari do të vëzhgohen nga Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave.
- Jam i informuar dhe dakord që nëse nuk i respektoj këto kushte, anëtari i afërt i familjes mund të përballet me masa disiplinore ndër të cilat mund të jetë ndërprerja e mandatit të tij/saj.
- Jam i informuar gjithashtu se informacioni i përftuar nga vëzhgimi mund të çojë në ndjekje penale, nëse ka prova për një vepër penale.
- Jam i informuar dhe dakord se këto kushte janë të rëndësishme dhe në përpjesëtim të drejtë me nevojën për të kryer hetime, ndjekje penale dhe gjykime çështjesh të rëndësishme pa u ndikuar nga ndërhyrjet korruptive.

- Jam i informuar dhe dakord se, nëse nuk jam më një anëtar i afërt i familjes së një personi i/e cili/cila do të caktohet me detyrë në një post që duhet të ketë besimin e posaçëm të publikut ashtu siç parashikohet nga ligji, atëherë do të jetë detyrimi im të informoj menjëherë Oficerin Përgjegjës të Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave lidhur me këtë fakt si dhe të paraqes prova shkresore që vërtetojnë ndryshimin e këtij statusi.

________, më ___.___.20___

**DEKLARUESI**
(_______________________)

[1]Specifiko në këtë rubrikë marrëdhënien me subjektin deklarues, për shembull i biri/e bija, vëllai/motra, nëna/babai, bashkëshorti/bashkëshortja etj.

**Shtojca C**

**Deklarimi i llogarive financiare**

**(Për kandidatët për gjyqtarë dhe pozicione të tjera në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, kandidatët për prokurorë dhe pozicione të tjera në Prokurorinë e Posaçme, kandidatët për drejtor, zëvendës drejtor, hetues, oficer të shërbimeve të policisë gjyqësore, dhe pozicione të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimi, si dhe anëtarët e afërt të familjes)**

**A. Rendisni më poshtë llogaritë tuaja financiare dhe informacionin e kërkuar:**

| Numri i llogarisë Financiare | Emri i mbajtësit të llogarisë | Institucioni Financiar | Shteti |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**B. Rendisni më poshtë llogaritë financiare të familjarëve tuaj dhe informacionin e kërkuar:**

| Numri i llogarisë Financiare | Emri i mbajtësit të llogarisë | Institucioni Financiar | Shteti |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

_____, më____.___._____ Emër, Mbiemër, Firma